

ANALIZA FUNKSIONALE E GJYKATËS KUSHTETUESE

Të Republikës Së Maqedonisë Së Veriut



Kingdom of the Netherlands



Институт за човекови права



TITULLI:

Analiza funksionale e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut

EDITOR:

Instituti për të Drejtat e Njeriut

PËR EDITORIN:

Margarita Caca Nikollovska

AUTOR:

Temellko Risteski

PËRKTHEU:

Blerina Starova Zlatku

DIZEJNI FIGURATIV DHE GRAFIK:

Damjan Kanzurov

Dhjetor 2020, Shkup

Projekti “Gjykata Kushtetuese – mbrojtëse e sundimit të së drejtës” është mbështetur nga Mbretëria e Holandës. Opinionet e prezantuara në këtë dokument janë opinione të autorit dhe nuk i pasqyrojnë çdoherë opinionet e donatorit.

PËRMBAJTJA

REZYME EKZEKUTIVE	5
HYRJE	6
QËLLIMI I ANALIZËS FUNKSIONALE	6
METODOLOGJIA	7
POZITA E GJYKATËS KUSHTETUESE NË RENDIN KUSHTETUES TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERITUT DHE PAVARËSIA E SAJ	9
PËRBËRJA PERSONALE E GJYKATËS KUSHTETUESE DHE PAVARËSIA E SAJ	11
Zgjedhja e gjyqtarëve kushtetues ose vendosja e “njerëzve tanë” për gjyqtarë kushtetues	12
Jurist i spikatur, çka është kjo?	13
Pa/barazia gjinore në Gjykatën Kushtetuese	14
Mos/përfaqësimi proporcional i pjesëtarëve të bashkësive etnike në personelin e Gjykatës Kushtetuese	14
Shërbimi profesional i Gjykatës Kushtetuese – shërbim pa të cilin nuk mundet	15
STATUSI JOMATERIAL DHE MATERIAL I PERSONELIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE DHE PAVARËSIA E SAJ	18
Gjyqtarë – statusi jomaterial	19
Gjyqtarë-statusi material	20
Nëpunësit në shërbimin profesional – nëpunës kushtetues – gjyqësor, dhe jo nëpunës administrativë	22
KOMPETENCAT E GJYKATËS KUSHTETUESE	25
Kompetencat themelore dhe të veçanta	26
VENDIMET E GJYKATËS KUSHTETUESE	28
Procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë	29
Procedura e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave nga neni 110, alineja 3 të Kushtetutës	31
<i>Pak kërkesa, pak kërkesa të marra në konsideratë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave</i>	32
Ankesë (padia) kushtetuese – shumë shtete e posedojnë, Maqedonia e Veriut nuk e posedon	33

EFIKASITETI DHE EFEKTIVITETI NË PUNËN E GJYKATËS KUSHTETUESE	35
A është Gjykata Kushtetuese jo/efikase sipas numrit të lëndëve të pranuar dhe të zgjidhura?	36
<i>Lëndë të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura, në nivel vjetor</i>	<i>36</i>
<i>Numri i lëndëve të zgjidhura sipas llojit të aktit për zgjidhje</i>	<i>38</i>
A mundet Gjykata Kushtetuese të jetë më efikase?	40
EKZEKUTIMI I VENDIMEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE	41
Aspekti përfundimtar, ekzekutiv dhe i detyrueshëm i vendimeve	42
Ekzekutimi, monitorimi dhe sigurimi i ekzekutimit.....	42
FINANCIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE OSE PAVARËSIA FINANCIARE	43
Paratë janë ushqim për institucionet, ndërsa Gjykata Kushtetuese është institucion.....	44
Pa para të mjaftueshme për Gjykatën Kushtetuese nuk ka mbrojtje efikase të sundimit të së drejtës	44
Problemi me pavarësinë financiare të gjykatës është i zgjidhshëm	45
KUSHTET E PUNËS NË GJYKATËN KUSHTETUESE	46
LIGJ OSE RREGULLORE PËR GJYKATËN KUSHTETUESE	48
Shumë shtete evropiane kanë Ligj për Gjykatën Kushtetuese, Maqedonia e Veriut nuk ka	49
Republika e Maqedonisë së Veriut nuk ka Ligj për Gjykatën Kushtetuese, a duhet të ketë?	49
TRANSPARENCA NË PUNËN E GJYKATËS KUSHTETUESE	52
Gjykata ka kushte për transparencë	53
BASHKËPUNIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE ME GJYKATAT KUSHTETUESE TË SHTETEVE TË TJERA	54
Përmes bashkëpunimit shkëmbehen ide, ndërsa idetë janë promotore të aksioneve.....	55
KONKLUZIONE	56
LITERATURA E PËRDORUR.....	58

REZYME EKZEKUTIVE

Ky dokument u hartua në kuadër të Projektit “Gjykata Kushtetuese – mbrojtëse e sundimit të së drejtës”, i implementuar nga Instituti për të Drejtat e Njeriut, me mbështetje të Mbretërisë së Holandës.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është identifikimi i problemeve me të cilat ballafaqohet Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga aspekti i strukturës organizative të saj dhe rolit në rendin kushtetues të Republikës, si autoritet për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Duke u nisur nga qëllimi kryesor i analizës, bëhen përpjekje të parashikohen masat specifike, të cilat nga aspekti organizativ dhe funksional parashtrohen si sfida para Gjykatës Kushtetuese për shkak të rritjes së shkallës së efikasitetit të saj në mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë.

Fillimisht u hartua analiza funksionale, ndërsa pason një analizë e thuktë e cila fokusohet mbi realizimin e qëllimit të përgjithshëm të Projektit “Gjykata Kushtetuese – mbrojtëse e sundimit të së drejtës”-në mënyrë që të theksohet rëndësia e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si mbrojtëse e sundimit të së drejtës dhe qëllimet e veçanta të saj – të rritet vetëdija për punën e Gjykatës Kushtetuese, të fokusohet interesimi i publikut në punën e saj dhe ndikimin e saj; të përmirësohet grumbullimi i të dhënave përmes monitorimit të vazhdueshëm dhe analizës së punës të Gjykatës Kushtetuese si dhe të rriten njohuritë e publikut për mekanizmat e aksesshëm për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të ligjeve dhe akteve juridike, si dhe të të drejtave e lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë para Gjykatës Kushtetuese.

Me qasjen aksiologjike të analizës mbi gjendjen e objektivit të përgjithshëm të Projektit, krijuam një dimension vlerash lidhur me kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, si imperativ për sundimin e të drejtës dhe vendosjen e drejtësisë në shoqëri, si vlerë më sublimë në marrëdhëniet shoqërore dhe si lajtmotiv i të drejtës.

HYRJE

Gjyqësori kushtetues në Republikën e Maqedonisë së Veriut i afrohet fundit të dekadës së gjashtë të ekzistimit të saj. Gjykata e parë Kushtetuese, si institucion i veçantë i rendit kushtetues për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve të tjera të përgjithshme, është inkorporuar në Kushtetutën e Republikës Socialiste të Maqedonisë në vitin 1963. Struktura kadrovike dhe organizative e saj, kompetenca e saj dhe procedurat për kryerjen e punëve në kompetencë të saj u rregulluan me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë, i cili është miratuar kah fundi i vitit 1963, ndërsa ka hyrë në fuqi në 30 janar të vitit 1964.

Me Kushtetutën e Republikës Socialiste të Maqedonisë, nga viti 1974 dhe Ligjin për bazat e procedurës dhe veprimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, nga viti 1976, u bënë ndryshime të vogla në kompetencën e gjykatës dhe në veprimin juridik të vendimeve të saj, megjithatë pozita e saj në raport me pushtetin ligjvënës dhe ekzekutiv mbeti e pandryshuar. Gjykata Kushtetuese ishte pjesë e sistemit të unitetit të pushtetit dhe e kishte për detyrë ta siguroj harmoninë e brendshme të rendit juridik.

Përfundimisht, me një pozitë pak të ndryshuar dhe me një rregullim më të ngushtë kushtetues, Gjykata Kushtetuese, si institucion i rendit kushtetues e inkorporon edhe Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë nga viti 1991.¹

Sipas nenit 108 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut është organ i Republikës që e mbron kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, dhe përmes saj e mbron edhe sundimin e së drejtës si njëra nga vlerat themelore të rendit kushtetues të Republikës.

QËLLIMI I ANALIZËS FUNKSIONALE

Qëllimi i analizës funksionale të Gjykatës Kushtetuese konsiston me detektimin e gjendjeve në lidhje me strukturën organizative dhe rolin e saj në rendin kushtetues. Në kuadër të këtij qëllimi themelor analiza i parashikon masat specifike me të cilat identifikohen sfidat me të cilat ballafaqohet Gjykata Kushtetuese nga aspekti organizativ dhe funksional. Shpresojmë se si rezultat i analizës, publiku profesional do të ketë mundësi të përcaktojë masa konkrete për përmirësimin e gjendjes dhe për realizimin më të mirë të qëllimeve të gjykatës.

Qëllimi i përcaktuar në këtë mënyrë i analizës funksionale është në funksion të apostrofimit të rëndësisë së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut si mbrojtëse e sundimit të së drejtës, e që në të vërtetë është synimi i përgjithshëm i Projektit “**Gjykata Kushtetuese – mbrojtëse e sundimit të së drejtës**” në kuadër të të cilit hartohet ky dokument. Projekti “**Gjykata Kushtetuese – mbrojtëse e sundimit të së drejtës**” u implementua nga Instituti për të Drejtat e Njeriut, me mbështetje financiare nga Ambasada e Holandës në Shkup.

¹ Shih më gjerësisht tek Shkariq S., (2004) E drejta Kushtetuese komparative dhe maqedonase, f. 679-685.

METODOLOGJIA

Parë nga aspekti metodologjik, analiza funksionale mund të trajtohet si metodë dhe si gjendje e perceptuar të punëve në lidhje me Gjykatën Kushtetuese, si mbrojtëse e sundimit të së drejtës. Që të arrijmë deri te gjendja e perceptuar të punëve, ajo duhet të perceptohet. Perceptimi i gjendjes së punëve, në bazë të analizës paraprakisht të kryer, paraqet sintezë.

Në rastin tonë, analiza funksionale i përfshinë të dy komponentët, pjesën analitike dhe pjesën sintetike. Me pjesën analitike të analizës funksionale janë prezantuar elementë për perceptimin e gjendjes, përkatësisht elementët e sintezës. Rezultati i perceptimit të gjendjeve (sinteza), është gjendja aktuale – pozita e Gjykatës Kushtetuese si pjesë e sistemit kushtetues të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pjesa analitike e analizës funksionale e përfshinë analizën normative, analizën politikologjike dhe analizën aksiologjike të pozitës së Gjykatës Kushtetuese në rendin kushtetues të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Me analizën normative përfshihen normat – dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, me të cilat është rregulluar pozita e Gjykatës Kushtetuese në rendin kushtetues të Republikës, përbërja e saj, statusi kushtetues i gjyqtarëve në të njëjtën, kompetenca e saj, si dhe çështje të tjera në lidhje me pozitën dhe rolin e Gjykatës Kushtetuese, si pjesë e sistemit kushtetues të Republikës.

Pastaj, me këtë analizë janë shqyrtuar dispozitat e Rregullores së Gjykatës Kushtetuese, si akt i përgjithshëm nënligjor për rregullimin e mënyrës së punës së Gjykatës Kushtetuese dhe procedurës para saj.

Përveç Rregullores së Gjykatës Kushtetuese, e analizuam edhe Rregulloren për organizimin e brendshëm të shërbimit profesional të Gjykatës, me Organogramin e prezantuar të organizimit të Gjykatës, si dhe Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës të shërbimit profesional të gjykatës, përmes Pasqyrës së prezantuar Tabelore të vendeve të punës të shërbimit.

Të dhëna shumë të rëndësishme për nevojat e analizës gjetëm në raportet vjetore – Pasqyra të punës së Gjykatës Kushtetuese.

Pastaj, iu bë analizë Ligjit për gjykata, Ligjit për pagat e gjyqtarëve, Ligjit për pagën dhe kompensimet e tjera të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të personave të tjerë të zgjedhur dhe të emëruar, Ligjit për pagat e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ligjit për pagat e prokurorëve publikë dhe Ligjit për pagat e anëtarëve të Këshillit të prokurorëve publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Me qëllim që të realizohet këqyrje në zhvillimin e gjyqësorit kushtetues në Maqedoninë e Veriut, nga themelimi i saj në vitin 1963 e deri më sot, u bë analiza e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese nga viti 1963 dhe Ligjit për bazat e procedurës para Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë nga viti 1976.

Përmes zbatimit të metodës komparative iu bë analizë dispozitave për përbërjen, kompetencat dhe financimin, të përfshira në dispozitat e Ligjeve për gjykatat kushtetuese të Republikës së Sllovenisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Serbisë, Republikës Serbska,

Republikës së Malit të Zi, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës. Pastaj, u analizuan dispozitat e përgjithshme – themelore të ligjeve për gjykatat kushtetuese të shteteve të tjera evropiane, si vijon: Austria, Bjellorusia, Gjermania, Letonia, Lituania, Moldavia, Finlanda, Rumania, Çekia, Rusia, Sllovakia, Polonia, Turqia, Hungaria dhe Ukraina.

Gjatë analizës shërbeheshim me interpretimin gramatikor, logjik, sistematik, teleologjik, komparativ dhe historik të normave që i përmbajnë aktet e cekura të përgjithshme juridike.

Me analizën politike përpiqemi t'i perceptojmë marrëdhëniet e Gjykatës Kushtetuese me bartësit e fuqisë dhe pushtetit politik në Republikë, të perceptuara përmes prizmit të Kushtetutës dhe ligjeve. Qëllimi i këtij perceptimi janë gjendjet dhe shkallët e varësisë së Gjykatës Kushtetuese nga të njëjtat, me synim të gjenden zgjidhje për reduktimin e varësisë.

Me qasjen aksiologjike bëme përpjekje që analizës funksionale t'ia japim dimensionin e vlerës. Dhënia e këtij dimensionin na mundësoi që në analizë të inkorporojmë përmbajtje të vlefshme sa i përket mbrojtjes të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë si imperativ për sundimin e të drejtës dhe vendosjen e drejtësisë në shoqëri, si vlerë më e lartë në marrëdhëniet shoqërore dhe si lajt motiv i të drejtës.²

Për hartimin e analizës funksionale u shfrytëzuan të dhëna nga faqja e internetit të Gjykatës Kushtetuese, të dhëna nga raportet vjetore për punën e Gjykatës, si dhe informacionet për ngjarjet dhe punët rrjedhëse të gjykatës.

Gjatë hartimit të analizës funksionale u mbajt takim pune ndërmjet përfaqësuesve të Institutit për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykatës Kushtetuese.

Pas takimit të punës u vendosën disa kontakte të telefonave me sekretarin e gjykatës. Së këtejmi, u kërkuan informacione shtesë, si dhe disa sqarime në lidhje me informacionet paraprakisht të pranuar dhe njohurit e fituara.

Në bazë të analizës së dispozitave të Kushtetutës, ligjeve dhe Rregullores së Gjykatës Kushtetuese, u shqyrtua pozita e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut në rendin kushtetues të Republikës.

² Kambovski V., Filozofia e të drejtës (2010), Akademia Maqedonase e Shkencave dhe Arteve, Shkup, f. 243 – 249.



01

**POZITA E GJYKATËS KUSHTETUESE
NË RENDIN KUSHTETUES TË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË
VERIUT DHE PA/VARËSIA E SAJ**

Sipas nenit 108 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut është organ i Republikës që e mbron kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë.

Në sistemin e mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë Gjykata Kushtetuese e zë vendin më të lartë. Vendimet e saj për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë janë të detyrueshme dhe ekzekutive për të gjitha subjektet juridike. Ato janë përfundimtare dhe ekzekutive. Kundër tyre nuk lejohet ankesë. Gjykata Kushtetuese është e pavarur nga autoritetet e tjera të pushtetit shtetëror. Me këtë, Gjykata Kushtetuese ngritet në nivelin e autoritetit më të lartë në mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë.

Nga pikëpamja juridike Gjykata Kushtetuese varet vetëm nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kushtetuta ka supremaci ndaj të gjitha autoriteteve të tjera publike. Ajo ka supremaci edhe mbi të gjitha aktivitetet e tyre, duke e përfshirë këtu edhe kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve të përgjithshme juridike nënligjore. Me një pozitë të këtillë në rendin kushtetues Gjykata Kushtetuese është në rolin e garantit për respektimin e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut si akt me veprim mbi ligjor.

Gjykatën Kushtetuese e përbëjnë nëntë gjyqtarë. Nuk ka gjykatë të pavarur kushtetuese nëse gjyqtarët janë të varur. Pikërisht në këtë drejtim Kushtetuta kësaj çështjeje i përkushton vëmendje të posaçme, me atë që siguron mekanizma për vendosjen e gjyqtarëve në pozitë të pavarur nga bartësit e pushtetit dhe nga personat të cilët posedojnë fuqi politike në Republikë. Këto mekanizma janë inkoherenca e funksionit gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese me ushtrimin e ndonjë funksioni dhe profesioni tjetër publik ose me anëtarësimin në parti politike, imuniteti i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe pamundësia që gjyqtari kushtetues, pa vullnetin e tij, të largohet nga funksioni para skadimit të mandatit, përveç në rastin nëse dënohet për vepër penale me dënim të pakushtëzuar me burgim prej më së paku gjashtë muaj ose nëse përgjithmonë e humb aftësinë për ushtrimin e funksionit të tij, të cilën gjë e konstaton vetë Gjykata Kushtetuese. **Pozita e Gjykatës Kushtetuese në rendin kushtetues të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës, i mundëson Gjykatës pavarësi funksionale.**

Megjithatë, praktika dëshmon se, sa i përket pavarësisë së Gjykatës Kushtetuese, aspekti normativ i përcaktuar me dispozitat e Kushtetutës, nuk korrespondon çdoherë me aspektin faktik. Pavarësia funksionale nuk është e mundshme pa pavarësinë administrative dhe financiare (buxhetore).



02

**PËRBËRJA PERSONALE E
GJYKATËS KUSHTETUESE
DHE PA/VARËSIA E SAJ**



Përbërja personale e Gjykatës Kushtetuese përbëhet nga gjyqtarët dhe punonjësit në shërbimin profesional të gjykatës.

ZGJEDHJA E GJYQTARËVE KUSHTETUES OSE VENDOSJA E “NJERËZVE TANË” PËR GJYQTARË KUSHTETUES

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese i zgjedh Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Kuvendi zgjedh tre gjyqtarë me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast duhet të ketë shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u përkasin bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (shumica e Badenterit).

Mandati i gjyqtarëve zgjat 9 vjet, pa të drejtë për rizgjedhje. Mandati i përcaktuar në këtë mënyrë i gjyqtarëve kushtetues e pamundëson koalicionin në pushtet t'i "vendosë" – zgjedhë të gjithë gjyqtarët kushtetues nga radhët e "njerëzve të vet". Megjithatë, në rast të qeverisjes më të gjatë të ndonjë koalicioni qeverisës, ekziston mundësia që të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të jenë nga radhët "e tanëve" – "njerëzve tanë" nga të cilët pritet të jenë të dëgjueshëm dhe të veprojnë sipas urdhrave të pushtetit.

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese zgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur.

Me Gjykatën Kushtetuese udhëheq kryetari, kur e zgjedh gjykata nga radha e gjyqtarëve me dy të tretën e shumicës së votave. Mandati i tij zgjat tre vjet, pa të drejtë për rizgjedhje.

Në kuadër të kompetencave të tyre kushtetuese, nga dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese propozon Presidenti i Republikës dhe Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Pesë gjyqtarët e tjerë i propozon Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve pranë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut funksionon dhe punon në kushte të një ambienti turbulent i cili karakterizohet me kundërthënie dhe përplasje të ashpra midis bartësve të fuqisë dhe pushtetit politik. Në kushte të një mjedisi turbulent dhe të pasigurtë politik artikulohej dy rreziqe të dëmshme për pozitën e Gjykatës Kushtetuese në funksion të mbrojtjes të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë.

Rreziku i parë konsiston me atë që ajo të politizohet, me synimin që mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë ta shfrytëzojë vetëm si paravan për imponimin e vet, si faktor politik. Rreziku i dytë konsiston me atë që ajo të mishërohet me pushtetin politik dhe në vend të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë faktike, të sigurojë kushtetutshmëri dhe ligjshmëri iluzive, në përputhje me interesat e garniturës në pushtet.

Në kushte të këtilla, Gjykata Kushtetuese mund të imponohet si mbrojtëse autoritative të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë vetëm nëse përbëhet nga njerëz me njohuri të mëdha profesionale, me ndjenjë jashtëzakonisht të zhvilluar për përgjegjësi para shoqërisë dhe qytetarëve, me një imagjinatë të zhvilluar të juristit dhe shoqërore për perceptimin e vizionit që e imponon vendosja dhe fuqizimi i sundimit të së drejtës, garantimi i të drejtave të njeriut dhe lirive qytetare dhe qëllime të tjera të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë së Veriut të përcaktuara në preambulën e Kushtetutës; si dhe me një shkallë të lartë të guximit personal të luftojnë për realizimin e saj, pavarësisht rrezikut që mund ta kenë mbi vetveten për shkak të mosdakordësimeve dhe pakënaqësisë nga ana e bartësve të fuqisë dhe pushtetit politik.

JURIST I SPIKATUR, ÇKA ËSHTË KJO?

Kushtetuta, në nenin 109, paragrafin 4, përcakton se gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese zgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur. Në lidhje me këtë parashtrohet pyetja lidhur me domethënien e nocionit “jurist i spikatur”, në funksion të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

Për përcaktimin më të saktë të këtij nocioni do të fillojmë nga kuptimi semantik i nocionit “i spikatur.” Ky termin e nënkupton qenien në realitetin objektiv (njeri, objekt, kafshë, bimë dhe ngjashëm) që sipas ndonjë tipari (madhësia, bukuria, mirësia, të qeni punëtor dhe ngjashëm) qëndron mbi të tjerët, qenie të përafërta me të, spikatet në raport me ata, qëndron mbi ta dhe ngjashëm.

Juristi i spikatur me tiparet e tij të dëshiruara prej juristi, qëndron mbi shumicën tjetër të juristëve. Ai, me njohuritë e tij, kulturën, moralin, elokuencën, është mbi juristët e tjerë. Ai është “vizibil”, emblematic në publikë. Atë e njeh jo vetëm publiku profesional por edhe publiku më i gjerë. Nuk është jurist i spikatur ai gjyqtar kushtetues i cili nuk është i njohur, jo vetëm për publikun e gjerë por edhe për kastën më të ngushtë të juristëve në shtet. Gjyqtar kushtetues – anonimus - është e kundërta dialektike e gjyqtarit Kushtetues – juristë i spikatur.

Kushtet të cilat duhet t’i plotësojë gjyqtari kushtetues – jurist i spikatur, në të vërtetë korrespondojnë me standardet përgjithësisht të pranuara ndërkombëtare për përkufizimin e nocionit – jurist i spikatur. Në të drejtën kushtetuese komparative përkufizimi i këtij nocioni, i cili më së shumti u përafrohet atyre standardeve, është sanksionuar në **Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Malit të Zi.**

Sipas këtij ligji (neni 9, paragrafi 2) “për juristë të spikatur konsiderohen profesorët e shkencave juridike, gjyqtarët, prokurorët shtetëror, avokatët, noterët, juristët të cilët punojnë në institucionet shtetërore, në institucionet e nivelit qendror dhe të nivelit lokal, si dhe juristët të cilët punojnë tek shoqëritë tregtare dhe tek personat juridikë, të cilët gëzojnë reputacion profesional dhe personal.”

Ky përkufizim mund të na shërbejë për një sqarim më të përafërt të nocionit “jurist i spikatur”, në përputhje me standardet përgjithësisht të pranuara ndërkombëtare për gjyqtarin kushtetues – jurist i spikatur. Si mangësi e ka përcaktimin e pamjaftueshëm të nocioneve reputacion “profesional dhe personal”, nga aspekti i mjedisit – ambientit në të cilin ky reputacion gëzohet. Reputacioni profesional mund të gëzohet në një mjedis më të ngushtë ose më të gjerë, përkatësisht në një rreth njerëzish (në një gjykatë, në një qytet, në një komunë, brenda shtetit si tërësi, përkatësisht midis të gjithë qytetarëve të shtetit etj.). Sa më i gjerë të jetë ky mjedis, atëherë reputacioni do të jetë gjithnjë e më i lartë. Nëse mjedisi është shteti, përkatësisht në rastin tonë Republika në tërësi, ose thënë më mirë qytetarët e saj, atëherë ky reputacion është më i lartë. Do të jetë akoma më i lartë nëse juristi gëzon reputacion profesional dhe personal edhe jashtë territorit të Republikës, për shembull, gjyqtar në Gjykatë Ndërkombëtare ose jurist në ndonjë institucion ndërkombëtar. Duke e pasur parasysh faktin se numri i juristëve të cilët gëzojnë reputacion profesional dhe personal edhe jashtë Republikës është i vogël, ne për ta përkufizuar nocionin – jurist i spikatur, sipas modelit të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Malit të Zi, mund të jemi të kënaqur nëse juristi, si ekspert specialist i të drejtës me një reputacion dhe dinjitet ekselent personal është i njohur për gjithë publikun maqedonas. **Sipas kësaj, gjyqtari kushtetues mund të jetë jurist i cili në përputhje me standardet përgjithësisht të pranuara ndërkombëtare për jurist të spikatur gëzon reputacion profesional dhe personal midis qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.**

Nga aspekti i karrierës – juristi i spikatur, para se të zgjidhet për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese duhet t'i kalojë të gjitha shkallët në fushën juridike në të cilën paraprakisht ka punuar.

Funksioni – gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese – është kulmi në karrierën e juristit. Nga ky kulm, pas skadimit të afatit, ai duhet të shkojë në pension të merituar, me stazh të plotë për pensionim. Nëse për gjyqtar të Gjykatës zgjidhet ndonjë jurist i ri, i cili pas skadimit të mandatit duhet të kthehet në radhët e profesionit juridik jashtë gjykatës, ekziston rrezikut t'u "vardiset" bartësve të pushtetit dhe fuqisë politike t'i sigurojnë një vend pune të sigurt dhe mirë të paguar në ndonjërin nga institucionet e shtetit ose në ndonjë vend tjetër për të cilin nevojitet "leja" nga ana e tyre. Kjo do ta vë në pozitë që të varet nga të njëjtit, ndërsa një gjyqtar i varur kushtetues nuk është mbrojtës i mirë i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë.

PA/BARAZIA GJINORE NË GJYKATËN KUSHTETUESE

Kur bëhet fjalë për përbërjen personale të Gjykatës Kushtetuese, mund të vërehet dominanca numerike e gjyqtarëve kushtetues-burra, në raport me gjykatëset kushtetuese-gra. Në përbërjen aktuale të gjykatës, **gjashtë gjyqtarë janë burra, kundrejt tri gjyqtareve gra**. Kjo është në kundërshtim me parimin e përfaqësimit të drejtë gjinor, për zbatimin e të cilit, kohëve të fundit, insistohet me të madhe. Nga ana tjetër, kjo është në kundërshtim edhe me parimin kushtetues të barazisë së qytetarëve para Kushtetutës dhe ligjeve nga neni 9 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Përkundrejt gjyqtarëve, në shërbimin profesional të gjykatës numerikisht dominojnë gratë. Ato përbëjnë 95% të personelit të shërbimit.

Nuk ka dyshime se gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese duhet të ketë përparësi profesionalizmi dhe cilësitë morale të kandidatëve. Megjithatë, është fakt se në mesin e mijëra juristeve-gra (profesoresha universitare, gjyqtare, avokate, nëpunëse administrative etj.) mund të gjenden gra të cilat e kanë atributin e juristes së spikatur, ashtu siç e kërkon pozita me përgjegjësi të madhe dhe me respekt të lart të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

Po ashtu, gjatë punësimit të nëpunësve në shërbimin profesional të Gjykatës Kushtetuese, në të ardhmen, duhet të mbahet llogari për barazinë gjinore, përmes dhënies përparësi profesionalizmit të kandidatëve.

MOS/PËRFAQËSIMI PROPORCIONAL I PJESËTARËVE TË BASHKËSIVE ETNIKE NË PERSONELIN E GJYKATËS KUSHTETUESE

Në gjykatë nuk është aplikuar madje as parimi i përfaqësimit proporcional të pjesëtarëve të bashkësive etnike në strukturën e të punësuarve. Në përbërjen e shërbimit profesional nga bashkësitë e tjera etnike ka vetëm një serb. Të tjerët janë maqedonas / maqedonase.³ Duke e pasur parasysh Amendamentin VI të Kushtetutës të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili e përcakton përfaqësimin e drejtë dhe adekuat të qytetarëve të cilët u përkasin të gjitha bashkësive në organet e pushtetit shtetëror dhe në institucionet e tjera publike, në të gjitha

3 Të dhënat janë siguruar nga kryetari dhe sekretari i Gjykatës.

nivelet, kjo tingëllon dëshpërueshëm. Edhe pse kriteri kryesor i punësimit në gjykatë duhet të jetë profesionalizmi, megjithatë duhet të mbahet llogari edhe për këtë parim në masë me të cilën nuk do të cenohet parimi i profesionalizmit. “Çdo gjë me masë” do të thoshte Aristoteli.

SHËRBIMI PROFESIONAL I GJYKATËS KUSHTETUESE – SHËRBIM PA TË CILIN NUK MUNDET

Shërbimi profesional i Gjykatës Kushtetuese përbëhet nga 20 nëpunës shtetërorë: këshilltarë të gjykatës, këshilltarë të pavarur, këshilltarë, bashkëpunëtorë profesionistë, si dhe punonjës administrativ dhe administrativ - teknik. Nga këshilltarët nëntë janë me statusin këshilltarë shtetërorë. Ai i kryen punët profesionale – analitike, informative dhe të dokumentacionit dhe punët administrative-teknike për nevojat e gjykatës.

Me shërbimin profesional udhëheq sekretari i Gjykatës Kushtetuese.

Organizimi i brendshëm i shërbimit profesional rregullohet me Rregulloren për organizimin e brendshëm të shërbimit profesional të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Rregullorja është miratuar në bazë të dispozitës së nenit 89, paragrafi 1 të Rregullores së Gjykatës Kushtetuese.

Punët dhe detyrat e shërbimit profesional kryhen në njësi organizative: dy sektorë dhe katër seksione të pavarura.

Sektorë në përbërjen e shërbimit profesional janë: Sektori për analizë dhe Sektori për punë të përgjithshme.

Në Sektorin për analizë kryhen punët profesionale-analitike dhe veprimet që ndërmerren gjatë fazës paraprake dhe fazave të tjera të procedurës për lëndët e formuara në gjykatë. Ky Sektor përbëhet nga Seksioni për punë profesionale – analitike dhe nga Seksioni për të drejtën komparative.

Sektorin për punë të përgjithshme i kryen punët për nevojat e kryetarit të gjykatës, si dhe punët që kanë të bëjnë me protokollin për nevojat e gjykatës, punët e komunikimit dhe administrative dhe të dokumentacionit për nevojat e gjyqtarëve, punët e përkthimit, lektorimi i materialeve dhe punë të tjera të shërbimit profesional të Gjykatës. Në kuadër të këtij Sektori bën pjesë Seksioni për punë administrative – teknike dhe Seksioni për punë të përgjithshme.

Përveç sektorëve dhe seksioneve brenda tyre, në shërbimin profesional të Gjykatës Kushtetuese formohen katër seksione të pavarura, si vijon:

- Seksioni – Kabineti i Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese,
- Seksioni për administrim me burime njerëzore,
- Seksioni për çështje financiare dhe
- Seksioni për auditimin e brendshëm.

Për kryerjen e punëve dhe detyrave të caktuara më komplekse, për trajtimin e çështjeve të caktuara, për kryerjen e punëve të cilat përfshijnë më shumë fusha, për realizimin e detyrave

dhe obligimeve të caktuara gjatë punës, si dhe për raste të tjera, Sekretari i Përgjithshëm me aktvendim të tij, mund të formojë komisione, grupe të punës dhe trupa të tjerë të punës.

Struktura organizative e shërbimit profesional të Gjykatës Kushtetuese, pa dyshim se plotësisht korrespondon me nevojat e shërbimit profesional të punëve dhe aktiviteteve në kompetencë të gjykatës. Me strukturën e këtillë organizative shërbimi profesional i gjykatës në mënyrë efikase dhe efektive mund ta kryejë shërbimin e punëve dhe aktiviteteve në kompetencë të saj, nënkuptohet, me kushtin që njësitë organizative të shërbimit të plotësohen me personelin e parashikuar me aktin – Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës.

Me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në shërbimin profesional të Gjykatës Kushtetuese, për kryerjen e punëve në kompetencë të shërbimit, parashikohen 45 vende pune me 67 realizues.

Vendet e punës në shërbimin profesional, të përcaktuara me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës, janë sistematizuar nëpër njësitë organizative të parashikuara me Rregulloren për organizimin e brendshëm të shërbimit profesional të Gjykatës Kushtetuese, për të cilat u bë fjalë më lartë.

Nga të dhënat e faqes së internetit të Gjykatës Kushtetuese mund të shihet se shërbimi profesional i Gjykatës Kushtetuese përbëhet nga 20 nëpunës shtetërorë.

Është evident disproporcioni i madh midis numrit të nëpunësve, të parashikuar me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në shërbimin profesional dhe numrit faktik të të punësuarve. Ky dispropocion e vë në dukje ekzistimin e plotësimi të pamjaftueshëm të shërbimit profesional me personel të nëpunësve. Kjo, padyshim, rezulton me mbingarkim me punë të nëpunësve ekzistues.⁴ Një gjë e këtillë pasqyrohet negativisht në cilësinë e punës të nëpunësve, në shërbimin profesional dhe mbi efikasitetin e shërbimit gjatë dhënies së shërbimeve profesionale për Gjykatën. Pikërisht për këtë, është më se e nevojshme që shërbimi profesional të plotësohet me kuadrin e nevojshëm të nëpunësve.

Në lidhje me këtë, ndërsa duke e pasur parasysh faktin se për çdo punësim të nëpunësve administrativë, sipas nenit 8 të Ligjit për nëpunësit administrativë duhet të jep pëlqim Ministria e Financave, atëherë gjendja e pafavorshme me plotësimin e shërbimit profesional mund të përkeqësohet akoma më shumë. Kjo e imponon nevojën e sigurimit të plotësimi efektiv të vendeve vakante të punës të shërbimit për shkak të pensionimit, largimit në vend tjetër të punës jashtë gjykatës dhe ngjashëm.

Plotësimi i pamjaftueshëm është burim i efikasitetit dhe efektivitetit të pamjaftueshëm gjatë kryerjes së punëve në kompetencë të gjykatës. Kushti themelor për kryerjen efikasë të çdo pune nga ana e një grupi të njerëzve është sigurimi i numrit të mjaftueshëm të personave profesionistë të cilët do të punojnë në realizimin e tyre.

Kur flasim për plotësimin e shërbimit profesional të Gjykatës Kushtetuese, një problem i veçantë gjatë kryerjes së punëve dhe detyrave në kompetencë të Gjykatës është mosplotësimi

⁴ Sipas njohurive tona në Gjykatë ka persona të cilët kryejnë punë të parashikuara madje edhe për tre vende pune në strukturë të ndryshme të punëve dhe detyrave të parashikuara me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës.

i shërbimit profesional me personel administrativ. Kështu që, personeli administrativ i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë i kryen punët administrative të Gjykatës, veçanërisht, pranimi i palëve dhe pranimi i shkresave, regjistrimi i të dhënave, detyrat për shmangien e punëve të panevojshme, dërgesat, përgatitja teknike e materialeve për seanca dhe arkivimi i dokumenteve e kryen vetëm një nëpunës shtetëror.

Në gjykatë nuk ka nëpunës të punësuar shtetëror i angazhuar për kryerjen e detyrave që kanë të bëjnë me zbatimin e procedurës për prokurime publike.

Veç tjerash, Gjykata nuk ka nëpunës të punësuar shtetëror i cili do të angazhohet për kryerjen e detyrave të teknologjisë së informacionit dhe internetit;

Përfundimisht, Gjykata nuk ka person të punësuar për kryerjen e detyrave që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen dhe administrimin e pronës që e përdor (nikoqir).

Përveç vendeve të punës të nëpunësve të shërbimit profesional të Gjykatës Kushtetuese, Rregullorja për sistematizimin e shërbimit parashikon edhe vende pune për personelin ndihmës-teknik. Këto janë vendet e punës sanitar, shofer dhe shofer i kryetarit.

**STATUSI JOMATERIAL DHE
MATERIAL I PERSONELIT TË
GJYKATËS KUSHTETUESE DHE
PA/VARËSIA E SAJ**

GJYQTARË – STATUSI JOMATERIAL

Statusi jomaterial i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese është përcaktuar me Kushtetutën dhe Rregulloren e Gjykatës. Sipas Kushtetutës (neni 109) gjyqtarët i zgjedh Kuvendi nga radha e juristëve të spikatur. Ata kanë imunitet. Për imunitetin e tyre nuk vendos subjekti jashtë Gjykatës Kushtetuese, por vet Gjykata.

Sipas Rregullores së Gjykatës Kushtetuese (neni 10), gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese gëzojnë imunitet si edhe deputetët në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, i përcaktuar me Kushtetutën e Republikës.

Duke u nisur nga e drejta e imunitetit të deputetëve, Rregullorja e Gjykatës Kushtetuese këtë të drejtë e përcakton në dy nivele: imunitet nga thirrja për përgjegjësi penale dhe imunitet për pacenueshmëri në lidhje me opinionin e prononcuar ose votimin në gjykatë. Kështu që, sipas Rregullores, gjyqtari nuk mund të thirret në përgjegjësi penale ose të arrestohet për opinionin e prononcuar ose për votimin në gjykatë. Ai nuk mund të arrestohet pa urdhër gjyqësor, përveç nëse është kapur në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale për të cilën është përcaktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej më së paku pesë vitesh. Imuniteti e mbron gjyqtarin kushtetues madje edhe atëherë kur ai vet nuk thirret në imunitet, nëse një gjë e këtillë është e nevojshme për ushtrimin e funksionit të tij dhe funksionin e gjykatës. Në këtë rast, për aplikimin e imunitetit, nënkuptohet, do të vendosë gjykata.⁵

Shkarkimi i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese nga detyra, pa vullnetin e tij, mund të bëhet vetëm me përjashtim. Deri në këtë, sipas Kushtetutës, mund të vijë kur do të krijohen rrethana të caktuara objektive: nëse gjyqtari dënohet për vepër penale me dënim të pakushtëzuar me dënim prej më së paku gjashtë muaj ose kur përgjithmonë do ta humbë aftësinë e ushtrimit të funksionit të tij.

Sipas kësaj, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese mund t'i pushojë funksioni para skadimit të mandatit kur ai do ta vë vetveten, me veprën e tij, në situatë që e bën jodinjitoz për ushtrimin e funksionit ose kur do të krijohen rrethana objektive për shkak të të cilave ai nuk është në gjendje ta ushtrojë funksionin e tij.

Ekzistimin e fakteve për pushimin e funksionit gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, për shkak të humbjes së përhershme të aftësisë për ushtrimin e tij, si dhe ekzistimin e fakteve për heqjen e imunitetit të gjyqtarit, sipas Rregullores së Gjykatës Kushtetuese e përcakton Gjykata, sipas mendimit paraprakisht të siguruar nga komisioni i përbërë nga tre gjyqtarë të Gjykatës.

Nga kjo që u tha më lartë mund të konkludojmë se **statusi jomaterial i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, i përcaktuar me dispozitat e Kushtetutës dhe Rregullores së Gjykatës, i siguron mbrojtje solide juridike, ndërsa me këtë edhe shkallë të lartë të pavarësisë gjatë punës.**

5 Në lidhje me këtë shih edhe Shkariq S., (2004), E drejta kushtetuese komparative dhe maqedonase, Matica makedonska, f. 687-689.

GJYQTARË – STATUSI MATERIAL

Statusi material i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, para së gjithash, përcaktohet me të ardhurat e tyre. Sipas nenit 32, paragrafi 4 të Kushtetutës të Republikës së Maqedonisë së Veriut, çdo i punësuar ka të drejtë për të ardhura përkatëse. Të ardhura përkatëse janë ato të ardhura të cilat i përgjigjen numrit dhe vëllimit të punëve dhe detyrave në vendin e punës, kompleksitetit të punës, përgjegjësisë e cila buron nga rëndësia e tyre shoqërore dhe nënkuptohet, vëllimit dhe cilësisë së realizimit gjatë kryerjes së punëve dhe detyrave. Duke i pasur parasysh problemet me të cilat ballafaqohen gjyqtarët gjatë punës dhe vendimmarrjes me lëndë në kompetencë të gjykatës, gjithsesi se kompleksiteti i punëve e zë nivelin më të lartë të mundshëm në punët juridike. Domethënia shoqërore e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë që e mbron Gjykatën Kushtetuese është në funksion të sundimit të së drejtës dhe drejtësisë, si vlerë më e lartë në marrëdhëniet shoqërore. Nga kjo domethënie shoqërore buron edhe shkalla më e lartë e përgjegjësisë së gjyqtarëve kushtetues në mbrojtjen e rendit kushtetues të Republikës. Vëllimi i realizimit, sipas viteve, duke gjykuar sipas raporteve vjetore të Gjykatës Kushtetuese, korrespondon me gjendjet objektive në shoqëri.

Duke e pasur parasysh këtë që u tha më lartë, **të ardhurat e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese duhet të jenë në grupin e të ardhurave më të larta në Republikë.** Të ardhurat duhet të jenë më të larta nga të ardhurat e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, të deputetëve në Kuvend, të ministrave. Gjyqtarët kushtetues janë ata të cilët e vlerësojnë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e akteve normative dhe vendimeve të cilat institucionet paraprakisht të apostrofuara i miratojnë dhe veprimeve që i ndërmarrin ata.

Të ardhurat⁶ përbëhen nga paga, shtojca në pagë dhe kompensime në pagë.

Komponenti kryesor, dhe me këtë edhe komponenti më i lartë i të ardhurave, është paga.

Pagat e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen në Ligjin për pagat dhe kompensimet e tjera të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe të personave të tjerë të zgjedhur dhe të emëruar në Republikë.⁷ Në bazë të këtij ligji, Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit dhe Kryetari i Qeverisë kanë koeficient më të lartë për përlogaritjen e pagës, që sipas mendimit tonë, është në rregull.

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e ka koeficientin e njëjtë si të zëvendës-kryetarëve të Kuvendit dhe të zëvendës-kryetarëve të Qeverisë. Edhe kjo, sipas mendimit tonë, po ashtu është në rregull. Koeficienti i pagës së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, sipas mendimit tonë duhet të jetë i njëjtë si edhe për anëtarët e Qeverisë, kryetarët e trupave punues të Kuvendit, Guvernatorit të Bankës Popullore dhe Avokatit të Popullit.

Megjithatë, siç theksuam më lartë, paga është vetëm komponent i të ardhurave.

Të ardhurat e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe i kryetarit të Gjykatës duhet të jenë menjëherë pas të ardhurave të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit dhe Kryetarit të Qeverisë. Vetëm këta mund të kenë të ardhura më të larta, për shkak të përgjegjësisë së tyre jashtëzakonisht të madhe gjatë ushtrimit të punëve të shumta dhe tejet komplekse shtetërore. Kjo do të arrihet me inkorporimin e shtojcave në pagë dhe me kompensimet në pagë.

6 Termin kushtetues nga neni 32, paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

7 Ligji për paga dhe për kompensime të tjera të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe të personave të tjerë të zgjedhur dhe emëruar në Republikë, "Gazeta Zyrtare e RSM" numër 36/1990 dhe 38/1991; GZ [Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë], nr.23/97, 37/05, 84/05, 121/07, 161/08, 92/09, 42/10, 97/10, 162/10, 11/12, 145/12, 170/13, 139/14

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese nuk janë e njëjta gjë si edhe gjyqtarët në gjykatat e rregullta. Ata janë gjyqtarë sui generis. Ata vendosin – gjykojnë për kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e ligjeve dhe akteve të tjera normative në bazë të të cilave gjykojnë gjyqtarët e gjykatave të rregullta; vendosin për kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e veprimeve të tyre sipas kërkesë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave etj. Kjo i vendos në pozitë më të lartë nga pozita në të cilën gjenden gjyqtarët e gjykatave të rregullta, e që në të vërtetë është e pakontestueshme. Duke e vlerësuar kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e ligjeve dhe akteve të tjera normative, ata kanë përgjegjësi të madhe. Nëse Gjykata Kushtetuese anulon ose shfuqizon ndonjë dispozitë ligjore dhe me këtë e pengon mundësinë e fitimit të shumave të mëdha të parave ose për arritjen e qëllimit të caktuar politik të bartësve të fuqisë dhe pushtetit politik, gjyqtarët të cilët kanë votuar për vendimin i ekspozohen rrezikut jashtëzakonisht të madh në krahasim me rrezikun të cilit i ekspozohen gjyqtarët e gjykatave të rregullta.

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, njëlloj si edhe gjyqtarët e gjykatave të rregullta, pranojnë informacione, punojnë dhe kryejnë veprime me një shkallë të lartë konfidencialitetit, e që jo rrallëherë është më i lartë nga ai i gjyqtarëve të gjykatave të rregullta.

Ata, po ashtu, punojnë në kushte stresi. Disa herë ishim dëshmitarë të sulmeve të vrazhda, etiketimeve dhe sulmeve ndaj dinjitetit dhe reputacionit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese për shkak të opinioneve dhe propozimeve të tyre.

Sipas Ligjit për pagat e gjyqtarëve (neni 7-b)⁸, gjyqtarët në gjykatat e rregullta kanë të drejtë për shtojca në pagë, si vijon: shtojcë për kushte të veçanta të punës, shtojcë për ekzistimin e rrezikut të lartë dhe shtojcë për konfidencialitet. Këto shtojca nuk përjashtohen midis tyre. Shuma e përgjithshme e lartësisë së këtyre shtojcave mund të jetë deri 35% të pagës themelore të gjyqtarit në gjykatën e rregullt. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese nuk kanë të drejtë për shtojca të këtyra, ndërsa gjithsesi se duhet ta kenë. Në lidhje me këtë, nga aspekti i drejtësisë, krejtësisht janë të arsyeshme ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores së Gjykatës Kushtetuese në tetor të këtij viti, me të cilat gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese e përcaktuan vet të drejtën e këtyre shtojcave. Kontestuese është vetëm çështja se një gjë e këtillë a mund të bëhet me Rregulloren e gjykatës. Jemi të mendimit se **një gjë e këtillë mund të bëhet vetëm me ligj**. Padyshim se të drejtat materiale, për realizimin e të cilave ndërhyhet në buxhetin e shtetit, përcaktohen vetëm me ligj. Padyshim se një gjë e këtillë e kanë të njohur edhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese. Sipas kësaj, ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores së gjykatës mund të kuptohen vetëm si mjet për presion mbi bartësit e pushtetit për zgjidhjen e çështjes së të ardhurave të gjyqtarëve kushtetues, në përputhje me shkallën e lartë të përgjegjësisë së tyre dhe pozitës së tyre shoqërore si mbrojtës më të mëdhenj të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së rendit kushtetues të Republikës.

Pastaj, paga e gjyqtarit të gjykatës së rregullt përcaktohet në mënyrë që baza shumëzohet me koeficientin e përcaktuar me Ligjin për pagat e gjyqtarëve, e rritur me përqindjen për përvojën e punës e cila vlerësohet me shtojcë në pagë prej 0,5% për çdo vit të filluar të stazhit të punës, dhe më së shumti deri në 20%.

Sipas Ligjit për pagat e gjyqtarëve, gjyqtari i gjykatës së rregullt ka të drejtë page e cila është përkatëse me peshën dhe reputacionin e funksionit të gjyqtarit të cilin e ushtron, rëndësinë e punës dhe përgjegjësinë e saj. Një përkatësi e këtillë nuk është parashikuar për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese. Pastaj, sipas Ligjit, paga e gjyqtarëve, e përcaktuar sipas dispozitave të tij, nuk mund të zvogëlohet me ligj ose me vendim të organit shtetëror.

8 Ligji për pagat e gjyqtarëve, "Gazeta Zyrtare" nr. 110/07, 103/08, 161/08, 153/09, 97/10, 67/10, 135/11, 231/15.

Për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese nuk ekziston një garanci e këtillë ligjore. Kjo do të thotë se pagat e tyre mund të zvogëlohen.⁹

Përveç të dhënave të theksuara, Ligji për pagat e gjyqtarëve parashikon edhe një numër të madh të kompensimeve të ndryshme, si vijon: kompensim për shpenzimet e rrugës, mëditje dhe për shpenzime të tjera për udhëtime zyrtare brenda dhe jashtë vendit; kompensim për transport deri dhe nga vendi i punës, sipas deklaratës paraprakisht të dhënë me shkrim të gjyqtarit vendbanimi i të cilët është më larg se 2,5 km nga vendi i punës, por jo më shumë se 900 denarë në muaj; kompensim të shpenzimeve për transportin e gjyqtarit i cili jeton në një komunë, ndërsa punon në komunë tjetër, në lartësinë e shpenzimeve reale për transport me mjet transportues të komunikacionit publik i cili mundëson arritjen në kohë dhe largim nga puna; kompensimi për ushqim në lartësi prej 25% nga paga mesatare mujore e paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut në tre muajt paraprak; kompensim për qiramarrjen e apartamentit për gjyqtarin i cili ka të drejtë të shfrytëzoj apartament zyrtar, në përputhje me ligjin, nëse nuk mund t'i sigurohet apartament dhe kompensime të tjera.

Gjyqtari i gjykatës së rregullt, përveç këtyre kompensimeve, ka të drejtë edhe për ndihmë në lartësi prej një page të fundit të paguar mesatare mujore në gjykatën në të cilën është punësuar, në rast të pushimit mjekësor më gjatë se gjashtë muaj dhe në rast të pasojave më të rënda nga fatkeqësitë elementare.

Përveç Ligjit për pagat e gjyqtarëve, në Republikën e Maqedonisë së Veriut në fuqi janë edhe ligje të tjerë të veçantë për paga, edhe atë: Ligji për pagat e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut,¹⁰ Ligji për pagat e prokurorëve publikë¹¹ dhe Ligji për pagat e anëtarëve të Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.¹²

Padyshim se të ardhurat e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese nuk korrespondojnë me shkallën e kompleksitetit të punëve që i kryejnë, me shkallën e përgjegjësisë, me kushtet e veçanta të punës dhe me shkallën e rrezikut ndaj të cilit janë të ekspozuar. Deri në miratimin eventual të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, kjo çështje mund të zgjidhet me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për paga dhe kompensime të tjera të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe të personave të tjerë të zgjedhur dhe të emëruar në Republikë. Me zgjidhjen e kësaj çështje do të përforcohet statusi material i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, e që gjithsesi do të ketë ndikim pozitiv mbi pavarësinë e tyre nga bartësit e pushtetit dhe fuqisë politike në shoqëri.

NËPUNËSIT NË SHËRBIMIN PROFESIONAL – NËPUNËS KUSHTETUES-GJYQËSOR, DHE JO NËPUNËS ADMINISTRATIVË

Sipas nenit 3 të Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në shërbimin profesional, për vendet e punës të përcaktuara me Rregulloren përcaktohen tituj në përputhje me Ligjin për nëpunësit shtetërorë dhe Urdhëresa për përshkrimin e titujve të nëpunësve shtetërorë si vijon: Sekretar i Përgjithshëm, Këshilltar shtetëror, Udhëheqës i sektorit,

9 Në lidhje me këtë, shih: Raporti përfundimtar i misionit, nga Jasna Omejec – Misioni i Ekspertëve të TAIEK për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga ana e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë JHA –IND/EXP 66095 nga muaji shkurt të vitit 2018.

10 Ligji për pagat e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, "Gazeta Zyrtare" nr.139/09.

11 Ligji për pagat e prokurorëve publik, "Gazeta Zyrtare" nr. 153/09.

12 Ligji për pagat e anëtarëve të Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Gazeta Zyrtare" nr. 139/09.

Udhëheqës i seksionit, këshilltarë, bashkëpunëtor i lartë, bashkëpunëtor, bashkëpunëtor i ri, referent i pavarur, referent i lartë dhe referent.

Ligji për nëpunësit shtetërorë pushoi të vlejë me fillimin e zbatimit të Ligjit për nëpunësit administrativë (në shkurt të vitit 2015). Kjo e imponon nevojën Rregullorja e sistematizimit të vendeve të punës në shërbimin profesional të Gjykatës Kushtetuese, deri në miratimin eventual të Ligjit të veçantë për Gjykatën Kushtetuese, të harmonizohet me Ligjin për nëpunësit administrativë. Ky ligj i përcakton kategoritë e vendeve të punës. Në kuadër të kategorive të vendeve të punës përcaktohen nivele të vendeve të punës. Nivelet e vendeve të punës, në kuadër të kategorive, përshkruhen në mënyrë plotësuese me tituj të cilët mbetën të njëjtë si edhe në Ligjin për nëpunësit shtetërorë.

Struktura organizative aktuale e Shërbimit profesional të Gjykatës Kushtetuese dhe zgjidhja e statusit të nëpunësve në të njëjtin, në përputhje me Ligjin me të cilin rregullohet statusi i – nëpunësve (shtetërorë) administrativë, nuk korrespondon me pozitën e Gjykatës Kushtetuese në rendin kushtetues të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjykata Kushtetuese është institucion sui generis. Ajo, sipas Kushtetutës, nuk i përket asnjërit nga pushtetet në sistemin e ndarjes së pushtetit shtetëror, si njëra nga vlerat themelore të rendit kushtetues të Republikës nga neni 8, paragrafi, 1, alineja 4 të Kushtetutës. Duke e pasur parasysh këtë ajo duhet të jetë maksimalisht e çliruar nga lidhjet me këto pushtete. Pavarësia maksimale e nënkupton shkallën më të lartë të pavarësisë. Nga ana tjetër, pavarësia absolute e nënkupton mungesën e cilësdo qoftë forme të varësisë. Kjo nuk është e mundur të arrihet askund në natyrë dhe shoqëri, madje as në rendin unik kushtetues të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjykata Kushtetuese do t'i përafrohet pavarësisë maksimale përmes rregullimit të shërbimit profesional, nëse ai ndahet nga administrata shtetërore si pjesë e pushtetit ekzekutiv në kuptimin e lidhjes së të punësuarve brenda saj me sistemin e nëpunësve administrativë dhe nga Agjencia për Administratë, si organ shtetëror kompetent për zbatimin e procedurës për punësimin e nëpunësve administrativë.

Nëse duam një Gjykatë të pavarur Kushtetuese, nëpunësit në shërbimin profesional nuk duhet të trajtohen si nëpunës administrativë, por si nëpunës të Gjykatës Kushtetuese, me status të veçantë sui generis në raport me nëpunësit administrativë. Punësimi i tyre dhe statusi i tyre në shërbimin profesional duhet të rregullohen me akt të veçantë, eventualisht me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese.

Me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese do të ndryshohen edhe titujt e nëpunësve. Së këtejmi, këshilltarët shtetërorë në Gjykatën Kushtetuese do të riemërohen në Këshilltarë kushtetues. Këshilltarët do të riemërohen në këshilltarë kushtetues-gjyqësor, bashkëpunëtorët e lartë – kushtetues gjyqësor, bashkëpunëtorët – bashkëpunëtorë kushtetues – gjyqësor etj., me shtimin e togfjalëshit “Kushtetues-Gjyqësor” pas çdo titulli.

Punësimi i nëpunësve në shërbimin profesional të Gjykatës Kushtetuese mund të bëhet përmes konkursit, të cilin do ta shpallë Gjykata, nënkuptohet përmes respektimit të procedurave standarde për zgjedhjen e kuadrit cilësor (rankimi i kandidatëve të paraqitur sipas kriterëve të parashikuara – të përcaktuara, intervistë dhe ngjashëm).

Ashtu siç zgjidhen gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese nga radhët e juristëve të spikatur, ashtu edhe të punësuarit në shërbimin profesional duhet të zgjidhen nga radha e aspirantëve më të mirë për punë në organet dhe institucionet e shtetit. Që të arrihet një gjë e këtillë, duhet të sigurohen stimuluesit e nevojshëm për punësim në Gjykatën Kushtetuese. Përveç autoritetit dhe reputacionit të institucionit Gjykata Kushtetuese, stimuluesi më i mirë është paga më e lartë. Pagat e nëpunësve në shërbimin profesional të Gjykatës nuk guxojnë të jenë të njëjta me pagat e nëpunësve administrativë në organet e administratës shtetërore. Ato duhet të jenë dukshëm më të larta. Ekspertët e mirë duhet të paguhen mirë.

Deri në miratimin eventual të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, statusi i nëpunësve në shërbimin profesional të gjykatës mund të zgjidhet përmes ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për nëpunësit administrativë, kështu që në të njëjtin mund të inkorporohet një pjesë e veçantë për nëpunësit administrativë në Gjykatën Kushtetuese.



04

**KOMPETENCAT E GJYKATËS
KUSHTETUESE**

KOMPETENCA THEMELORE DHE TË POSAÇME

Sipas nenit 108 të Kushtetutës të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kompetenca themelore e Gjykatës Kushtetuese, si autoritet i Republikës, përkatësisht i rendit kushtetues konsiston me mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë.

Nga kompetenca themelore e Gjykatës Kushtetuese burojnë kompetencat e saj të veçanta. Për përcaktimin e këtyre kompetencave të gjykatës u aplikua metoda e enumeracionit pozitiv që ka të bëjë me numërimin e tyre taksativ. Kjo u bë me dispozitat e nenit 110 të Kushtetutës. Sipas këtyre dispozitave Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut:

- vendos për harmonizimin e ligjeve me Kushtetutën;
- vendos për harmonizimin e akteve të tjera juridike dhe marrëveshjeve kolektive me Kushtetutën;
- i mbron liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit që kanë të bëjnë me lirinë e bindjes, vetëdijes, mendimit dhe prononcimit publik të opinionit, bashkimin dhe veprimin politik dhe ndalimin e diskriminimit të qytetarëve në bazë të gjinisë, racës, përkatësisë fetare, kombëtare, sociale dhe politike;
- e zgjidh konfliktin e kompetencave midis bartësve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor;
- e zgjidh konfliktin e kompetencave midis organeve të Republikës dhe njësive të vetëqeverisjes lokale;
- vendos për përgjegjësinë e Presidentit të Republikës;
- vendos për kushtetutshmërinë e programeve dhe statuteve të partive politike dhe të shoqatave të qytetarëve dhe
- vendos për çështje të tjera të përcaktuara me Kushtetutë.

Sa i përket vendimmarrjes për harmonizimin e ligjeve me Kushtetutën dhe sa i përket harmonizimit të akteve të tjera normative dhe marrëveshjeve kolektive me Kushtetutën dhe ligjet, Gjykata Kushtetuese realizon kontroll normativ mbi aktet e përgjithshme juridike.

Përmes kontrollit normativ Gjykata Kushtetuese në të vërtetë e kontrollon kushtetutshmërinë e të drejtës pozitive, përkatësisht e mbron veprimin superior të Kushtetutës në rendin juridik të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kjo nënkupton se Gjykata Kushtetuese bën kontroll normativ vetëm mbi aktet e përgjithshme në fuqi. Sa u përket akteve të përgjithshme që nuk janë në fuqi, në Rregulloren është parashikuar mundësia që Gjykata të vendos për kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e aktit normativ i cili nuk është në fuqi pasi që është ngritur procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së tij.

Përveç ligjeve, marrëveshjeve kolektive dhe programeve e statuteve të partive politike identifikimi i të cilëve si akte normative është unike, para gjykatës mund të kontestohet kushtetutshmëria dhe ligjshmëria e llojeve të ndryshme të tjera të akteve normative të cilat në mënyrë të përgjithshme rregullojnë çështje të caktuara (urdhëresa, rregullore, urdhra, udhëzime, vendime etj. të organeve shtetërore dhe të organeve të vetëqeverisjes lokale ose të

organizatave të cilat ushtrojnë autorizime publike). Në lidhje me këtë është e rëndësishme të theksohet se gjykata e pranon kompetencën edhe atëherë kur bëhet fjalë për akt i cili nuk e kënaq formën e aktit normativ, por është evidente se rregullon çështje të caktuara në mënyrë të përgjithshme.

Në kuadër të kontrollit normativ, gjykata mund të vendos për kushtetutshmërinë ose për ligjshmërinë e aktit në tërësi, ose të pjesëve të veçanta apo neneve, varësisht nga gjetjet në iniciativën dhe vlerësimin personal.

Sa i përket mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit, të garantuara me Kushtetutën e Republikës, Gjykata Kushtetuese parashikon mbrojtje të drejtpërdrejtë vetëm të disa lirive dhe të drejtave të njeriut dhe jo të të gjitha lirive dhe të drejtave të cilat me Kushtetutë iu garantohen qytetarëve të Republikës. Gjykata siguron mbrojtje të drejtpërdrejtë të lirive dhe të drejtave si vijon: liria e besimit, vetëdijes, mendimit dhe prononcimit publik të opinionit; bashkimi dhe veprimi politik dhe ndalimi i diskriminimit të qytetarëve në bazë të gjinisë, racës, përkatësisë fetare, kombëtare, sociale dhe politike.

Kompetenca kushtetuese e Gjykatës Kushtetuese për zgjidhjen e konfliktit të kompetencës më saktësisht është rregulluar me Rregulloren e gjykatës. Sipas Rregullores (neni 62 deri 66) Gjykata Kushtetuese vendos për zgjidhjen e konfliktit të kompetencës midis bartësve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe midis organeve të Republikës dhe njësive të vetëqeverisjes lokale.

Në kuadër të kompetencës kushtetuese për përgjegjësinë e Presidentit të Republikës, Gjykata Kushtetuese vendos për më shumë çështje të përcaktuara në Kushtetutë, si vijon: për heqjen e imunitetit të Presidentit të Republikës (neni 83), për krijimin e kushteve për pushimin e funksionit të tij (neni 82) dhe për përcaktimin e përgjegjësisë së tij (neni 87). Procedurat e vendimmarrjes për këto çështje më në detaje rregullohen në Rregulloren e Gjykatës Kushtetuese.



05



**VENDIMET E GJYKATËS
KUSHTETUESE**



SPROCEDURA E VLERËSIMIT TË KUSHTETUTSHMËRISË DHE LIGJSHMËRISË

Procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë të ligjit ose të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së aktit të përgjithshëm nënligjor inicohet me aktvendim të Gjykatës Kushtetuese, konform iniciativës së paraqitur. Secili mund të paraqesë iniciativë për ngritjen e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë të ligjit ose kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së aktit të përgjithshëm nënligjor (actio popularis).

Përveç kësaj, edhe Gjykata Kushtetuese mund të iniciojë procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë të ligjit ose kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së aktit të përgjithshëm nënligjor.

Gjatë shqyrtimit të kushtetutshmërisë të ligjit ose kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të aktit të përgjithshëm nënligjor Gjykata Kushtetuese mund ta vlerësojë edhe kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e dispozitave të ligjit ose të aktit të përgjithshëm nënligjor të cilat nuk janë kontestuar me iniciativën.

Në lidhje me mundësinë Gjykata Kushtetuese të iniciojë procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit dhe të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të aktit të përgjithshëm nënligjor, vëmendjen e tërheq dispozita e nenit 16, paragrafi 2 të Rregullores së gjykatës, sipas të cilës, veç tjerash, nëse iniciativa është paraqitur nga parashtrues i panjohur, do të konsiderohet se nuk është paraqitur, të cilën gjë sekretari do ta konstatoj me shkresë. Parashtrohet pyetja, **“pse Gjykata Kushtetuese nuk ngren procedurë edhe për iniciativën e këtillë, nëse tanimë mund të ngre procedurë sipas detyrës zyrtare”**. Është përgjithësisht e njohur se ka qytetarë të cilët kanë frikë nga reperkusionet, nëse haptas, me emër dhe mbiemër, paraqesin iniciativë për vlerësimin e kushtetutshmërisë të ligjeve dhe kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve të përgjithshme nënligjore. Në praktikë një gjë e këtillë ndodhë tek të punësuarit në organet dhe institucionet shtetërore dhe në organet dhe institucionet e tjera të cilat kryejnë autorizime publike. Ata kanë frikë nga reperkusionet nëse paraqesin iniciativë për kontestimin e kushtetutshmërisë ose ligjshmërisë së aktit të përgjithshëm nënligjor të organit, përkatësisht institucionit në të cilin janë punësuar, kështu që një gjë të këtillë do ta bënin me kënaqësi në mënyrë anonime. Në këtë rast, iniciativa e paraqitur nga një parashtrues anonim mundet dhe duhet të jetë shkas për ngritjen e procedurës sipas detyrës zyrtare nga ana e Gjykatës Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë, përkatësisht kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së aktit të përgjithshëm nënligjor.

Në lidhje me këtë rekomandohet të ndiqet praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sipas së cilës parashtruesi, i cili dëshiron të mbetet anonim, e nënshkruan iniciativën, megjithatë nga gjykata kërkon që të mbrohet anonimiteti i tij. Nëse ekziston një kërkesë e këtillë, gjykata e ka për detyrë ta mbrojë anonimitetin. Së këtejmi, nënshkrimi dhe të dhënat e tjera personale e lehtësojnë komunikimin midis gjykatës dhe parashtruesit të iniciativës.

Duke vepruar sipas iniciativës Gjykata Kushtetuese mund të miratojë aktvendim për ngritjen ose mos ngritjen e procedurës.

Gjatë procedurës, Gjykata Kushtetuese deri në miratimin e vendimit përfundimtar, mund të miratojë aktvendim për pezullimin e ekzekutimit të akteve ose veprimeve të veçanta që janë ndërmarrë në bazë të ligjit ose aktit të përgjithshëm nënligjor, kushtetutshmërinë

përkatësisht ligjshmërinë e të cilit e vlerëson, nëse me ekzekutimin e tij do të mund të paraqiteshin pasoja vështirë të rikuperueshme. Në një rast të këtillë, Gjykata Kushtetuese e ka për detyrë ta përfundojë procedurën në afat sa më të shkurtër.

Gjykata Kushtetuese, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit ose kushtetutshmërisë apo ligjshmërisë të aktit të përgjithshëm nënligjor, miraton vendim.

Kur Gjykata Kushtetuese do të gjejë se ligji ose dispozita e tij janë në kundërshtim me Kushtetutën ose me aktin e përgjithshëm nënligjor apo dispozita e tij është në kundërshtim me Kushtetutën ose ligjin, mund të miratojë dy lloje të vendimeve – anuluese ose shfuqizuese.¹³

Në përputhje me nenin 79 të Rregullores, vendimi i Gjykatës Kushtetuese me të cilin shfuqizohet ose anulohet ligji ose akti i përgjithshëm nënligjor prodhon veprim juridik nga dita e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.”

Veprimi juridik i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese varet nga lloji i vendimit. Kështu që, nëse bëhet fjalë për vendim të gjykatës me të cilin është anuluar ligji ose ndonjë dispozitë e tij, ose akti i përgjithshëm nënligjor apo ndonjë dispozitë e tij, veprimi i tij është retroaktiv – prapaveprues nga dita e publikimit të Vendimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” (ex tunc). Sipas këtij rregulli, vendimet e këtilla të gjykatës veprojnë jo vetëm në të ardhmen por edhe në mënyrë retroaktive-prapavepruese nga momenti i miratimit të ligjit ose ndonjë akti tjetër normativ të anuluar.

Për dallim nga vendimet anuluese, veprimi juridik i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese me të cilat shfuqizohet ligji ose ndonjë dispozitë e tij apo akti i përgjithshëm nënligjor ose ndonjë dispozitë e tij (vendime shfuqizuese), ka të bëjë vetëm me të ardhmen. Kjo nënkupton se ligji i shfuqizuar ose akti i përgjithshëm nënligjor pushon së zbatuari dhe të prodhojë veprim juridik exnunc (nga shfuqizimi, në vazhdim), ndërsa pasojat nga zbatimi, deri në shfuqizimin e tij, do të mbesin.

Në lidhje me këtë kompetencë ka indicie për prezencën e qasjes normative të gjyqtarëve gjatë vendimmarrjes. Së këtejmi, ekziston rreziku vlerësimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së ligjeve dhe akteve të përgjithshme nënligjore të nënkuptohet si harmonizim formal të akteve hierarkike juridike më të ulëta, me aktet juridike më të larta hierarkike, ndërsa Gjykata Kushtetuese të shndërrohet në vlerësues formal të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së tyre, së këtejmi pa ndikim esencial mbi procesin e realizimit të kushtetutshmërisë në jetën shoqërore. Ky rrezik është aq më i madh, nëse në Gjykatën Kushtetuese ka më shumë gjyqtarë pa njohuri të gjera të problemeve shoqërore të aspektit politik, social, social-psikologjik, juridik-filozofik, ekonomik dhe të aspekteve të tjera. Kjo mënyrë e ushtrimit të funksionit kushtetues-gjyqësor është më i lehtë për gjyqtarët dhe shumë komod për Gjykatën Kushtetuese si institucion i rendit kushtetues, meqë u mundëson jetë të qetë në shoqëri pa rreziqe nga vërejtjet nga ana e bartësve të fuqisë dhe pushtetit politik. Në këtë drejtim shkon edhe **mungesa shumëvjeçare e procedurave të ngritura sipas iniciativës së vet të Gjykatës Kushtetuese**. Parashtues në numër më të madh të iniciativave për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve të përgjithshme nënligjore janë qytetarët. Njohësi i mirë i të drejtës kushtetuese mund të gjejë shkelje të kushtetutshmërisë në shumë ligje dhe

13 Në përputhje me nenin 73 të Rregullores së Gjykatës Kushtetuese, gjatë vendimmarrjes se Ligji ose akti i përgjithshëm nënligjor a do të shfuqizohet ose anulohet, Gjykata i merr në konsideratë të gjitha rrethanat e rëndësishme për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, dhe veçanërisht rëndësinë e shkeljes dhe natyrën e saj dhe rëndësinë e realizimit të lirive dhe të drejtave të qytetarëve ose për marrëdhëniet e vendosura në bazë të atyre akteve, siguria juridike dhe rrethanat tjera të rëndësishme për vendimmarrjen.

në një numër akoma më të madh të akteve të përgjithshme nënligjore. **Prandaj, shoqëria me të drejtë mund të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese angazhim më të madh në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve të përgjithshme nënligjore, sipas iniciativës së saj.**

Gjykata Kushtetuese për herë të parë veprimi sipas iniciativës së vet (proprio motu), duke e kontestuar kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e pesë urdhëresave me fuqi ligjore, me ç'rast vendosi të ngre procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së tre prej tyre.

PROCEDURA PËR MBROJTJEN E LIRIVE DHE TË DREJTAVE NGA NENI 110, ALINEJA 3 TË KUSHTETUTËS

Pas vlerësimit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve të përgjithshme nënligjore, funksioni i radhës për nga rëndësia i Gjykatës Kushtetuese është mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit. **Kushtetutës të Republikës së Maqedonisë së Veriut mund t'i bëhet vërejtje për përfshirjen e vogël të lirive dhe të drejtave, mbrojtja e të cilave është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese.** Kështu që, sipas dispozitës së nenit **110, alineja 3 të Kushtetutës**, në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese është përfshirë mbrojtja e lirive dhe të drejtave që kanë të bëjnë me lirinë e bindjes, vetëdijes mendimit dhe prononcimit publik të opinionit, bashkimin dhe veprimin politik dhe ndalimin e diskriminimit të qytetarëve në bazë të gjinisë, racës, përkatësisë fetare, kombëtare, sociale dhe politike.

Kjo dispozitë e Kushtetutës nuk korrespondon me dispozitat e saj të nenit 50, sipas të cilave, çdo qytetar mund të thirret në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të përcaktuara me Kushtetutë para gjykatave dhe para Gjykatës Kushtetuese, në procedurë të bazuar mbi parimet e prioritetit dhe urgjencës.

Në përputhje me Rregulloren, **për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave Gjykata Kushtetuese vendos, sipas rregullit, në bazë të seancës së mbajtur publike (neni 55)** në të cilën thirren pjesëmarrësit e procedurës dhe Avokati i Popullit, ndërsa sipas nevojës mund të thirren edhe persona të tjerë, organe ose organizata. Nëse disa nga pjesëmarrësit në seancën publike nuk marrin pjesë, ndërsa janë thirrur me rregull, seanca mund të mbahet.

Sipas njohurive të fituara nga këqyrja e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, **në një numër të madh të procedurave sipas kërkesave të parashtruara për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, nuk mbahet seancë publike.** Ky veprim është në kundërshtim me nenin 55 të Rregullores së gjykatës, në përputhje me të cilin, siç është theksuar më lartë, sipas rregullit, për kërkesat për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave vendoset pas seancës së mbajtur publike.

Nga analiza e dispozitave të rregullores mund të konkludohet se mbajtja e seancave publike i është lënë vullnetit të gjykatës, përkatësisht nuk është precizuar në cilën mënyrë vendoset për mbajtjen ose mos mbajtjen e seancës publike.

Mos mbajtja e seancave publike për kërkesat e parashtruara, në përputhje me Rregulloren dhe përcaktimin e notës për vet gjykatën që ajo të veprojë në mënyrë selektive dhe për cilat lëndë do të mbajë seancë publike, flet për **transparencën e pamjaftueshme të**

gjykatës ndaj publikut, dhe për mungesën e vullnetit për përfshirjen e publikut profesional me qëllim të miratimit të vendimit të drejtë dhe fitimit të mbështetjes (besimit) nga publiku për punën e gjykatës.

Në lidhje me këtë duhet të theksohet se nuk është praktikuar as mbajtja e seancave përgatitore. Kjo praktikë u tejkalua këtë vit me mbajtjen e katër seancave përgatitore, dhe kjo gjithsesi është një hap pozitiv në punën e gjykatës, ndërsa kjo gjë padyshim se çon drejt cilësisë më të mirë.

Me vendimin për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit Gjykata Kushtetuese do të konstatoj se a ekziston shkelja e tyre, dhe varësisht nga kjo do ta shfuqizojë aktin e veçantë, do ta ndalojë veprimin me të cilin është bërë shkelja ose do ta refuzojë kërkesën.

Gjatë procedurës Gjykata Kushtetuese mund të miratojë aktvendim për pezullimin e ekzekutimit të aktit të veçantë ose veprimit deri në miratimin e vendimit përfundimtar.

Pak kërkesa, pak kërkesa të marra në konsideratë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut sot një çështje shumë e rëndësishme dhe shumë aktuale është efektiviteti i këtij mjeti juridik në lidhje me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarëve. Praktika dëshmon se numri i lëndëve për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarëve para Gjykatës Kushtetuese është shumë i vogël. Në periudhën kohore nga 1 janari i vitit 2010, deri në 31 dhjetor të vitit 2019, gjykata ka trajtuar 121 kërkesa për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit. Prej tyre janë marrë në konsideratë vetëm tri (një në vitin 2010, një tjetër në vitin 2018 dhe e treta në vitin 2019). Në 118 lëndët e tjera kërkesat janë refuzuar si të pabaza, ose janë hedhur poshtë mbi baza të ndryshme. Është e rëndësishme ajo që madje në vitin 2010 gjykata e ka miratuar vendimin e parë me të cilin ka konstatuar shkelje të lirive dhe të drejtave, pra 19 vjet të plota nga pavarësia e Republikës si shtet. Bëhet fjalë për vendimin e lëndës U.nr. 84/2009, nga data 10 shkurt të vitit 2010, me të cilin gjykata konstatoi se personit Xh.R. nga fshati Zajas i është cenuar e drejta për veprim politik.

Numri i madh i kërkesave të refuzuara ose të hedhura poshtë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, nga numri edhe ashtu i vogël i kërkesave të paraqitura shpie në konkluzionin se qytetarët janë pamjaftueshëm të informuar me kushtet se kur mund të kërkohet mbrojtja e lirive dhe të drejtave, si dhe me natyrën juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Nga ana tjetër, numri i vogël i kërkesave të paraqitura për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit para Gjykatës Kushtetuese vë në dukje konkluzionin se qytetarët nuk kanë besim të mjaftueshëm në Gjykatën Kushtetuese. Në lidhje me këtë, ka indicie se Gjykata Kushtetuese punën për këto lëndë e percepton si punë sporadike, dhe më pak të rëndësishme. Për këtë shkak ajo këtyre kërkesave nuk ua përkushton vëmendjen e merituar. Shkaku i dytë për numrin e vogël të lëndëve për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave është pasojë e kornizës shumë të ngushtë kushtetuese sipas të cilës qytetarët mund të kërkojnë mbrojtje të lirive dhe të drejtave. Kjo e imponon nevojën që korniza kushtetuese për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarëve para Gjykatës Kushtetuese të zgjerohet, ndërkaq të inkorporohet edhe mjeti juridik – ankesë (padi) kushtetuese.

ANKESË (PADI) KUSHTETUESE – SHUMË SHTETE E POSEDOJNË, MAQEDONIA E VERIUT NUK E POSEDON

Ankesa (padi) kushtetuese është mjet juridik për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarëve para Gjykatës Kushtetuese.

Publiku ekspert në Republikën e Maqedonisë së Veriut është i ndarë sa i përket çështjes së inkorporimit të ankesës kushtetuese, përkatësisht padisë. Sipas njërës palë, ankesën kushtetuese në tanimë e kemi në sistemin e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të qytetarëve. Bëhet fjalë për kërkesën për mbrojtjen e njeriut dhe qytetarit, të përcaktuar me Rregulloren e Gjykatës Kushtetuese, ndërkaq e mbështetur në dispozitat e nenit 110, alineja 3 të Kushtetutës. Duke e pasur parasysh faktin se korniza e lirive dhe të drejtave të cilat i mbron Gjykata Kushtetuese është shumë e ngushtë (i përfshinë vetëm liritë dhe të drejtat që kanë të bëjnë me lirinë e bindjes, vetëdijes, mendimit dhe opinionit publikisht të prononcuar, bashkimin dhe veprimin politik dhe ndalimin e diskriminimit të qytetarëve në bazë të gjinisë, racës përkatësisë fetare, kombëtare, sociale dhe politike), ajo duhet të zgjerohet edhe sa u përket lirive dhe të drejtave të tjera të cilat iu garantohen qytetarëve në kapitullin e dytë të Kushtetutës me titullin “Liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit”.

Sipas të tjerëve, në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese është e nevojshme të inkorporohet mjeti juridik me emërtimin “ankesë kushtetuese” ose “padi kushtetuese”. Sipas tyre, ankesa (padi) kushtetuese është inkorporuar në të gjitha shtetet e rajonit (dhe më gjerë) dhe bazohet në parimin subsidiaritetit – parim të cilin e kërkon Këshilli i Evropës. Ajo është përfshirë në kompetencën e gjykatave kushtetuese të Sllovenisë, Kroacisë, Bosnjë e Hercegovinës (Gjykata e Apelit) Serbisë, Malit të Zi. **Me sanksionimin e saj në këto shtete plotësisht është mbuluar mbrojtja e lirive dhe të drejtave të qytetarëve** në raste kur nuk është siguruar mbrojtje tjetër gjyqësore ose kur janë absolvuar të gjitha mjetet juridike për këtë mbrojtje para gjykatave të rregullta ose para organeve të administratës. Për dallim nga ato, në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë së Veriut ekzistojnë fusha për të cilat ose nuk ka mjet juridik, apo mjeti i parashikuar juridik është joefikas, dhe për këtë shkak qytetarët ankohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

Pastaj, sipas tyre, në një situatë “ideale” hipotetike, me ankesën (padinë) kushtetuese qytetarët kushtimisht thënë do të vinë shumë më shpejtë deri te drejtësia, ndërsa Gjykata Kushtetuese menjëherë do ta shqyrtonte dhe do të vendoste se një zgjidhje ose procedurë e caktuar ligjore për të cilën ankohet qytetari a është në përputhje me Kushtetutën.¹⁴

Nëse Republika e Maqedonisë së Veriut e sanksionon ankesën ose padinë kushtetuese si mjet efikas juridik vendor, të gjithë ankuesit (aplikantët), para se të shkojnë në Strasburg,

14 Në vitin 2014 u bënë përpjekje për inkorporimin e ankesës kushtetuese me draft-amendamente të Kushtetutës të Republikës. Përpjekjet dështuan. Në lidhje me draft-amendamentet, Komisioni i Venecias vuri në dukje se kjo reformë do të jetë e suksesshme vetëm me një përgatitje të kujdesshme e cila do të kërkoj miratimin e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe me një përkufizim të qartë në Kushtetutë në lidhje me përfshirjen e të drejtave themelore të cilat janë të mbrojtura. Në lidhje me argumentet e draft-amendamenteve të Kushtetutës për inkorporimin e ankesës kushtetuese Margarita Caca Nikollovska do të shkruaj: “Argumentet e prezantuar aspak nuk ishin të qarta dhe koncize, por përkundrazi propozoheshin me një arsytim shumë të shkurtër të paqëndrueshëm dhe jopërkatës dhe prezantuan një gjendje konfuzioni, veçanërisht kur merret parasysh vendosja e sistemit paralel dhe nevojës për mjete juridike efektive dhe efikase. Është mirë që Kuvendi këto draft-amendamente nuk i vendosi në rend dite, meqë kishte shumë elemente për veprim joadekuat, në mesin e të cilëve: procedura e shkurtuar parlamentare në mungesë të opozitës dhe mospasjes së debatit publik dhe të debateve profesionale në lidhje me përmbajtjen e këtyre amendamenteve.” Shih: Nikollovska – Caca M., (2016) Dialogu juridik numër 11/2016, Instituti për të Drejtat e Njeriut, Shkup.

do të jenë të detyruar ta shfrytëzojnë këtë mjet juridik vendor. Me këtë jepet mundësia Gjykata Kushtetuese ta rishikoj situatën para se të dërgohet në Strasburg. Me sanksionimin e padisë kushtetuese qytetarët do të vijnë shumë më shpejtë deri te drejtësia, sesa të presin me vite në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Sipas kësaj me sanksionimin e padisë kushtetuese në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut do të sigurohet mbrojtje më efikase të lirive dhe të drejtave të qytetarëve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës dhe me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në rastet kur **janë absolvuar ose nuk janë parashikuar mjete të rregullta ose të jashtëzakonshme juridike vendore për mbrojtjen e tyre.**

Sanksionimi i padisë kushtetuese do të jetë një reformë e madhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Sanksionimi i këtij mjeti juridik për mbrojtje gjithëpërfshirëse të të drejtave kushtetuese, si dhe vendosmëria që të zgjidhen çështjet e mbrojtjes të të drejtave të njeriut, në nivel kombëtar u mbështet edhe nga Komisioni i Venecias,¹⁵ i cili theksoi se kur një shtet i caktuar i qaset sanksionimit të padisë kushtetuese, kjo duhet të bëhet në atë mënyrë që nuk do ta prolongojë tej mase procedurën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Sanksionimi i këtij mjeti juridik në masë të konsiderueshme do të kontribuojë në përmirësimin e përgjegjësisë gjatë punës dhe cilësisë së vendimeve të cilat i miratojnë gjyqtarët në gjykatat e rregullta dhe personat zyrtarë në organet e administratës shtetërore. Ata, duke e ditur se vendimi i tyre përfundimisht mund të shkojë edhe në revizion në Gjykatën Kushtetuese, padyshim se gjatë zhvillimit të procedurës dhe miratimit të vendimeve, do të punojnë me përgjegjësi më të madhe dhe në mënyrë më cilësore.

Çështja e sanksionimit eventual të ankesës (padisë) kushtetuese dhe mënyra e sanksionimit do të elaborohet në detaje përmes analizës së thuktë, e cila do të hartohet në kuadër të këtij Projekti.

15 Raporti përfundimtar i Misionit të Jasna Omejec, Misioni i Ekspertëve të TAIEX për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga ana e Gjykatës Kushtetuese, Shkup, shkurt 2018 f. 15-18.



06



**EFIKASITETI DHE EFEKTIVITETI NË
PUNËN E GJYKATËS KUSHTETUESE**

A ËSHTË GJYKATA KUSHTETUESE JO/EFIKASE SIPAS NUMRIT TË LËNDËVE TË PRANUARA DHE TË ZGJIDHURA?

Përgjigjen në këtë pyetje përpiqemi ta gjejmë në raportet vjetore të Gjykatës Kushtetuese. Në mënyrë që ta gjejmë përgjigjen e kësaj pyetjeje i analizuam vendimet e Gjykatës Kushtetuese sipas viteve, për një periudhë pesëvjeçare, duke filluar nga 1 janari i vitit 2015 dhe përfundimisht me 31 dhjetor të vitit 2019.

Lëndë të pranuar, të zgjidhura dhe të pa zgjidhura, në nivel vjetor

- **Në periudhën kohore nga 1 janari, dhe përfundimisht me 31 dhjetor të vitit 2015,** gjykata ka trajtuar gjithsej 234 lëndë. Prej tyre 128 lëndë janë pranuar gjatë vitit 2015, ndërsa 106 janë bartur si të papërfunduara nga vitet paraprake. Nga numri i përgjithshëm i lëndëve në punë, brenda vitit kanë përfunduar 150 lëndë, ndërsa të papërfunduara kanë mbetur 84 lëndë.
- **Në periudhën kohore nga 1 janari, dhe përfundimisht me 31 dhjetor të vitit 2016,** gjykata ka trajtuar gjithsej 265 lëndë. Prej tyre 181 lëndë janë pranuar gjatë vitit 2016, ndërsa 84 lëndë janë bartur si të papërfunduara nga vitet paraprake. Nga numri i përgjithshëm i lëndëve në punë brenda vitit kanë përfunduar 161 lëndë, ndërsa të papërfunduara kanë mbetur 104 lëndë.
- **Në periudhën kohore nga 1 janari, dhe përfundimisht me 31 dhjetor të vitit 2017,** gjykata ka trajtuar gjithsej 279 lëndë. Prej tyre 168 lëndë janë pranuar gjatë vitit 2017, ndërsa 111 janë bartur si të papërfunduara nga vitet paraprak. Nga numri i përgjithshëm i lëndëve në punë brenda vitit kanë përfunduar 134 lëndë, ndërsa të papërfunduara kanë mbetur 145 lëndë.
- **Në periudhën kohore nga 1 janari, dhe përfundimisht me 31 dhjetor të vitit 2018,** gjykata ka trajtuar gjithsej 282 lëndë. Prej tyre 137 lëndë janë pranuar gjatë vitit 2018, ndërsa 145 janë bartur si të papërfunduara nga vitet paraprak. Nga numri i përgjithshëm i lëndëve në punë brenda vitit kanë përfunduar 211 lëndë, ndërsa të papërfunduara kanë mbetur 71 lëndë.
- **Në periudhën kohore nga 1 janari, dhe përfundimisht me 31 dhjetor të vitit 2019,** gjykata ka trajtuar gjithsej 238 lëndë. Prej tyre 167 lëndë janë pranuar gjatë vitit 2019, ndërsa 71 janë bartur si të papërfunduara nga vitet paraprak. Nga numri i përgjithshëm i lëndëve në punë brenda vitit kanë përfunduar 114 lëndë, ndërsa të papërfunduara kanë mbetur 124 lëndë.
- **Në periudhën kohore pesëvjeçare nga 1 janari i vitit 2015 dhe përfundimisht me 31 dhjetor të vitit 2019,** gjykata ka trajtuar gjithsej 1298 lëndë. Prej tyre 781 lëndë janë pranuar gjatë vitit rrjedhës, ndërsa 517 lëndë janë bartur si të papërfunduara nga vitet paraprak. Nga numri i përgjithshëm i lëndëve në punë brenda kësaj periudhe pesëvjeçare deri në fund të vitit kanë përfunduar 770 lëndë, ndërsa për vitet e ardhshëm kanë mbetur të papërfunduara 528 lëndë.

Duke i pasur parasysh të dhënat e prezantuara, shqetëson numri i lëndëve të papërfunduara brenda vitit në të cilin janë pranuar, dhe si të këtyra kanë mbetur të papërfunduara për vitet në vijim. Është e kuptueshme se shumica e lëndëve të pranuar në dy ose eventualisht

në tre muajt e fundit të vitit nuk mund të kryhen brenda atij viti dhe për këtë shkak duhet të barten për zgjidhje në vitin e ardhshëm. Megjithatë, në vitin e ardhshëm zgjidhja e këtyre lëndëve duhet të jetë prioritare.

Indikatorët e theksuar më lartë vënë në dukje indicie për **ekzistimin e avashllëkut, përkatësisht vonesës në procedurat për zgjidhjen e lëndëve dhe efikasitetit të pamjaftueshëm të gjykatës gjatë punës**. Kjo rezulton me kohëzgjatje të procedurave. Kohëzgjatja e procedurave është indicie për efikasitet të pamjaftueshëm të gjykatës gjatë punës.

Kur flasim për kohëzgjatjen e procedurës para Gjykatës Kushtetuese, ky është një problem ekzistues, dhe duke e pasur parasysh gjendjen aktuale, do të ekzistoj edhe në të ardhmen, kështu derisa kjo gjendje nuk tejkalohet.

Rezultate të mira në shkurtimin e kohëzgjatjes së procedurave ofron klasifikimi i lëndëve në urgjente, shumë urgjente, emergjente dhe pa shënimin për urgjencë. Së këtejmi, lëndët urgjente merren në punë menjëherë pas pranimit. Pasi që të zgjidhen, kalohet në lëndët shumë urgjente, pastaj në ato emergjente dhe në fund në lëndët që janë pa shënimin urgjente.¹⁶


Nga ana tjetër, numri prej 1298 lëndë në punë, për një periudhë pesëvjeçare (ose në nivel vjetor 259,6 lëndë), nuk flet për ekzistimin e mbingarkimit të gjykatës me punë.¹⁷

Kur bëhet fjalë për efikasitetin e punës së gjykatës, gjithsesi se duhet të vihet në pah jokonciziteti, i vendimeve të saj. Kështu për shembull, tek vendimet për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, në vend që të theksohet dispozita e Kushtetutës e cila është cenuar me dispozitën e kontestuar të ligjit ose të aktit nënligjor, citohen edhe dispozita të tjera të Kushtetutës të cilat nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me dispozitën e cenuar. Përveç kësaj, në vendime prezantohen gjetje nga iniciativat, të cilat janë irelevante për vendimin e gjykatës. Kjo vendimet i bën jokoncize. Për hartimin e vendimeve të këtilla pa nevojë shpenzohet koha dhe energjia e bashkëpunëtorëve profesionistë edhe ashtu të mbingarkuar me punë, që gjithsesi e redukton efikasitetin e punës së tyre, ndërsa me këtë, nënkuptohet, reduktohet edhe efikasiteti i punës së gjykatës.

16 Bëhet fjalë për përvojën e autorit të analizës së fituar në Seksionin për konteste administrative të ish-Gjykatës Ushtarake Supreme. Sipas njohurive të autorit, kjo praktikë është aplikuar edhe në Gjykatën Federative të ish-RSFJ. Klasifikimi i këtillë i motivoi gjyqtarët që në Seksionin të punojnë më shpejtë. Së këtejmi, duhet të mbahet llogari "të mos harrohen" lëndët pa shënimin e urgjencës.

17 Në lidhje me këtë, duhet të theksohet fakti se në vitin 2020 vëllimi i punës së Gjykatës Kushtetuese shënoi rritje drastike, me atë që 250 urdhëresa me fuqi ligjore ishin objekt vlerësimi të kushtetutshmërisë nga ana e tij. Pa dyshim se gjendja e jashtëzakonshme imponoi një angazhim të jashtëzakonshëm dhe në masë të konsiderueshme më të madh të Gjykatës Kushtetuese në mbrojtje të kushtetutshmërisë.

Lëndë në Gjykatën Kushtetuese në 5 vitet e fundit



Numri i lëndëve të zgjidhura sipas llojit të aktit për zgjidhje

Për vlerësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të Gjykatës Kushtetuese një indikator i rëndësishëm është numri i lëndëve të zgjidhura sipas llojit të aktit të gjykatës me të cilin ka përfunduar procedura. Sa i përket kësaj çështjeje gjendja në pesë vitet e fundit, duke filluar nga 1 janari i vitit 2015 dhe përfundimisht me 31 dhjetor të vitit 2019, është si vijon:

- **во 2015 година, në vitin 2015**, me vendime për shfuqizim të ligjit ose të aktit tjetër të përgjithshëm apo të ndonjë dispozite të tij, nga gjykata janë zgjidhur 11 lëndë, nuk është zgjidhur asnjë lëndë me vendim për anulim, me vendime për refuzim të iniciativës janë zgjidhur 2 lëndë, nuk është zgjidhur asnjë lëndë me vendim për përcaktimin e shkeljes së lirive dhe të drejtave, me aktvendime për mos ngritje të procedurës janë zgjidhur 73 lëndë, me aktvendime për hedhjen poshtë të iniciativës/kërkesës janë zgjidhur 59 lëndë, nuk është zgjidhur asnjë lëndë me aktvendim për pezullimin e procedurës, me përfundim administrativ (neni 16, neni 13 dhe neni 15 të Rregullores) janë zgjidhur 4 lëndë dhe me përfundim në mënyrë tjetër është zgjidhur 1 lëndë.
- **në vitin 2016** me vendime për shfuqizimin e ligjit ose aktit tjetër të përgjithshëm apo dispozitës së tij nga gjykata janë zgjidhur 15 lëndë, me vendim për anulim është zgjidhur 1 lëndë, me vendim për refuzimin e iniciativës është zgjidhur 1 lëndë, nuk është zgjidhur asnjë lëndë me vendim për përcaktimin e shkeljes së lirive dhe të drejtave, me aktvendime për mos ngritjen e procedurës janë zgjidhur 67 lëndë, me aktvendime për hedhjen poshtë të iniciativës/kërkesës janë zgjidhur 73 lëndë, me aktvendim për pezullimin e procedurës është zgjidhur 1 lëndë, me përfundim administrativ (neni 16, neni 13 dhe neni 15 të Rregullores) janë zgjidhur 2 lëndë dhe me përfundim në mënyrë tjetër nuk është zgjidhur asnjë lëndë.
- **në vitin 2017**, me vendime për shfuqizimin e ligjit ose aktit tjetër të përgjithshëm apo të dispozitës së tij, nga gjykata janë zgjidhur 18 lëndë, me vendime për anulim janë zgjidhur 3 lëndë, nuk është zgjidhur asnjë lëndë me vendim për refuzimin e iniciativës, nuk është zgjidhur asnjë lëndë me vendim për përcaktimin e shkeljes së lirive dhe të drejtave, me aktvendime për mos ngritjen e procedurës janë zgjidhur 47


lëndë, me aktvendime për hedhjen poshtë të iniciativës/kërkesës janë zgjidhur 63 lëndë, nuk është zgjidhur asnjë lëndë me aktvendim për pezullimin e procedurës, me përfundim administrativ (neni 16, neni 13 dhe neni 15 të Rregullores) janë zgjidhur 3 lëndë dhe me përfundim në mënyrë tjetër nuk është zgjidhur asnjë lëndë.

- **në vitin 2018**, me vendime për shfuqizimin e ligjit ose aktit tjetër të përgjithshëm apo të ndonjë dispozite të tij nga gjykata janë zgjidhur 32 lëndë, me vendime për anulim janë zgjidhur 22 lëndë, me vendim për refuzimin e iniciativës është zgjidhur 1 lëndë, me vendim për përcaktimin e shkëljes së lirive dhe të drejtave është zgjidhur 1 lëndë, me aktvendime për mos ngritje të procedurës janë zgjidhur 63 lëndë, me aktvendime për hedhjen poshtë të iniciativës/kërkesës janë zgjidhur 83 lëndë, me aktvendime për pezullimin e procedurës janë zgjidhur 3 lëndë, me përfundim administrativ (neni 16, neni 13 dhe neni 15 të Rregullores) është zgjidhur 1 lëndë dhe me përfundim në mënyrë tjetër janë zgjidhur 5 lëndë.
- **në vitin 2019**, me vendime për shfuqizimin e ligjit ose aktit tjetër të përgjithshëm apo të dispozitës së tij nga gjykata janë zgjidhur 8 lëndë, nuk është zgjidhur asnjë lëndë me vendim për anulim, me vendim për refuzimin e iniciativës është zgjidhur 1 lëndë, me vendim për përcaktimin e shkëljes së lirive dhe të drejtave është zgjidhur 1 lëndë, me aktvendim për mos ngritje të procedurës janë zgjidhur 40 lëndë, me aktvendime për hedhjen poshtë të iniciativës/kërkesës janë zgjidhur 60 lëndë, me aktvendim për pezullimin e procedurës është zgjidhur 1 lëndë, me përfundim administrativ (neni 16, neni 13 dhe neni 15 të Rregullores) janë zgjidhur 2 lëndë dhe me përfundim në mënyrë tjetër është zgjidhur 1 lëndë.

Gjithsej, në periudhën kohore pesëvjeçare nga 1 janari i vitit 2015 dhe përfundimisht deri më datë 31 dhjetor të vitit 2019, me vendime për shfuqizimin e ligjit ose aktit tjetër të përgjithshëm apo të dispozitës së tij nga gjykata janë zgjidhur 84 lëndë, me vendim për anulim janë zgjidhur 26 lëndë, me vendime për refuzimin e iniciativës janë zgjidhur 5 lëndë, me vendim për përcaktimin e shkëljes të lirive dhe të drejtave janë zgjidhur 2 lëndë, me aktvendime për mos ngritje të procedurës janë zgjidhur 290 lëndë, me aktvendime për hedhjen poshtë të iniciativës/kërkesës janë zgjidhur 338 lëndë, me aktvendim për pezullimin e procedurës janë zgjidhur 5 lëndë, me përfundim administrativ (neni 16, neni 13 dhe neni 15 të Rregullores) janë zgjidhur 12 lëndë dhe me përfundim në mënyrë tjetër janë zgjidhur 8 lëndë.

Këtu shqetëson numri i aktvendimeve për mos ngritje të procedurës dhe i aktvendimeve për hedhjen poshtë të iniciativës/kërkesës në raport me numrin e vendimeve shfuqizuese dhe anuluese.

Numri i lëndëve të zgjidhura sipas llojit të aktit



A MUNDET GJYKATA KUSHTETUESE TË JETË MË EFIKASE?

Në lidhje me efikasitetin e Gjykatës Kushtetuese në punën e saj, jemi të mendimit se gjendja aktuale në të cilën gjendet nuk është e përshtatshme që t'i mundësojë efikasitet më të madh.

Gjykata nuk e ka pavarësinë e nevojshme financiare dhe administrative, ndërsa kjo është imperativ për efikasitet më të madh funksional.

Financimi i gjykatës nuk korrespondon me nevojat e saj. Shuma e mjeteve të cilat i përcaktohen asaj me Buxhetin e Republikës nuk mjafton për funksionimin e saj normal dhe papengesa.

Shërbimi profesional është plotësuar me një të tretën e personelit të parashikuar me Rregulloren e sistematizimit të vendeve të punës e që siç u theksua më lartë pasqyrohet negativisht në efikasitetin e punës së saj. Shërbimi profesional pamjaftueshëm efikas çon në insuficiencë të efikasitetit të punës së Gjykatës Kushtetuese.



07



**EKZEKUTIMI I VENDIMEVE TË
GJYKATËS KUSHTETUESE**



7 ASPEKTI PËRFUNDIMTAR, EKZEKUTIV DHE I DETYRUESHËM I VENDIMEVE

Nga aspekti i ekzekutimit, vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë disa karakteristika esenciale. Ato janë përfundimtare dhe ekzekutive. Përveç kësaj ato janë të detyrueshme. Secili të cilit i referohen ato e ka për detyrë t'i ekzekutojë. Aspekti ekzekutiv i vendimit të Gjykatës Kushtetuese nënkupton se nuk ka kurrfarë pengesa procedurale për ekzekutimin e tij në praktikë, përkatësisht pengesa të cilat mund të paraqiten në procedurën e ekzekutimit të aktgjykimëve të gjykatave të rregullta. Kjo cilësi e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në mënyrë të drejtpërdrejtë rezulton nga plotfuqishmëria dhe nga aspekti përfundimtar i tyre, përkatësisht nga pamundësia që subjektet e pakënaqura juridike të shfrytëzojnë mjete juridike për shmangien e tyre.

Përmes ekzekutimit vendimi realizohet në praktikë. Kur bëhet fjalë për vendimet e Gjykatës Kushtetuese, me ekzekutimin shmanget nga rendi juridik ligji jokushtetues ose ndonjë dispozitë e tij, si dhe akti normativ jokushtetues apo joligjor ose ndonjë dispozitë e tij.

EKZEKUTIMI, MONITORIMI DHE SIGURIMI I EKZEKUTIMIT

Sipas dispozitave të nenit 86 të Rregullores, vendimet e Gjykatës Kushtetuese i ekzekuton miratuesi i ligjit, aktit tjetër normativ ose aktit të përgjithshëm, i cili me vendim të gjykatës është anuluar, ose shfuqizuar.

Vendimet me të cilat gjykata vendos për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, të përcaktuara me Kushtetutë, i ekzekuton organi ose organizata që e ka miratuar aktin e veçantë i cili me vendim të gjykatës është anuluar, përkatësisht organi ose organizata që e ka ndërmarr veprimin të cilin Gjykata Kushtetuese me vendim e ka ndaluar.

Gjykata Kushtetuese e ka për detyrë ta monitorojë ekzekutimin e vendimeve të veta dhe sipas nevojës të kërkojë nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ta sigurojë ekzekutimin e tyre.

Sipas informacioneve të pranuar në takimin e punës, të mbajtur më datë 27 tetor të vitit 2020 me përfaqësuesit e Gjykatës Kushtetuese, në krye me kryetarin e gjykatës, punët sa i përket monitorimit të ekzekutimit të vendimeve i janë besuar sekretarit të gjykatës, i cili, i ngarkuar me shumë obligime të tjera, i ka kryer me vështirësi.

Në takimin e punës me përfaqësuesit e Gjykatës Kushtetuese, e cila i parapriu kësaj analize funksionale, u vu në dukje problemi i formalizimit gjatë veprimit të ekzekutimit të vendimeve. Me fjalë të tjera, organi i cili e ka pasur për detyrë ta ekzekutojë vendimin ka miratuar akt të ri të përgjithshëm, përkatësisht e ka korigjuar dispozitën e aktit me ndryshime dhe plotësime të papërfillshme me një ose me disa fjalë me të cilat në të vërtetë, nuk shmanget shkelja e Kushtetutës, përkatësisht të ligjit, dhe pas kësaj ka pasur mundësi të ketë iniciativë të re ose ka pasur iniciativë të re për vlerësimin e kushtetutshmërisë, përkatësisht të kushtetutshmërisë ose ligjshmërisë të aktit të përgjithshëm. Me një veprim të këtillë "shpërfillet" vendimi i Gjykatës Kushtetuese, e që nga pikëpamja juridike-etike nuk lejohet. Përveç kësaj, me veprimin e këtillë pa nevojë rritet numri i lëndëve para gjykatës.



08

**FINANCIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE
OSE PA/VARËSIA FINANCIARE**

PARATË JANË USHQIM PËR INSTITUCIONET, NDËRSA GJYKATA KUSHTETUESE ËSHTË INSTITUCION

Buxheti i Gjykatës Kushtetuese është pjesë e buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në fund të çdo viti rrjedhës Gjykata Kushtetuese e përpilon Propozim buxhetin për vitin e ardhshëm, në të cilin i parashikon nevojat e veta të mjeteve financiare për funksionimin dhe realizimin papengësë të kompetencave të veta. Ky propozim i dërgohet Ministrisë së Financave, e cila e harton Draft-Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ia paraqet Qeverisë së Republikës. Qeveria e përcakton tekstin e buxhetit dhe ia paraqet Kuvendit për miratim. Në këtë udhëtim të gjatë neglizhohen nevojat e Gjykatës Kushtetuese. Për këtë shkak **gjykatës asnjëherë nuk i janë akorduar aq mjete sa ka kërkuar, por mesatarisht, 20% më pak nga mjetet e nevojshme**. Meqë Qeveria nuk ka detyrim ta ndërmarr buxhetin e projektuar të Gjykatës Kushtetuese dhe ta inkorporojë në Buxhetin e Republikës, gjykata shpeshherë vihet në situatë të reagojë, madje edhe me amendamente, të lusë të intervenohet në tekstin e Buxhetit të Republikës në mënyrë që të sigurohen mjete për funksionimin e saj normal.

Kjo, gjithsesi se ka të bëjë me pozitën kushtetuese të Qeverisë si propozues i vetëm i Buxhetit para Kuvendit si dhe me faktin se Gjykata Kushtetuese nuk ka kurrfarë instrumenti që të luftojë kundër organizimit të këtyllë të punëve sa i përket propozimit dhe miratimit të Buxhetit.

Në situata të këtylla sa i përket financimit të Gjykatës Kushtetuese nuk mund të bëhet fjalë për pavarësinë e saj financiare. Varësia financiare e gjykatës nga bartësit e pushtetit ekzekutiv dhe ligjvënës madje mund të jetë pika e saj më e dobët. Ajo, me sa duket, varet nga vullneti i Ministrisë së Financave, nga vullneti i Qeverisë dhe nga vullneti i Kuvendit. Në gjendjen aktuale të financimit të gjykatës është evident fakti se nuk ka koordinim të mjaftueshëm midis Ministrisë së Financave dhe Gjykatës. Kjo paraqet problem plotësues gjatë planifikimit adekuat të mjeteve për punën e gjykatës.

PA PARA TË MJAFTUESHME PËR GJYKATËN KUSHTETUESE NUK KA MBROJTJE EFIKASE TË SUNDIMIT TË SË DREJTËS

Nëse pushteti me të vërtetë dëshiron që në shtet të vendoset dhe përfordhet sundimi i së drejtës atëherë duhet t'i sigurojë mjete të mjaftueshme Gjykatës Kushtetuese. Kur bëhet fjalë për marrëdhëniet shoqërore, për çdo gjë tjetër mund të mos ketë para, por për punën e Gjykatës Kushtetuese dhe për punën e gjykatave të rregullta dhe prokurorive doemos duhet të ketë para. Ato janë në vijën e parë të drejtësisë. Nëse nuk ka drejtësi në marrëdhëniet shoqërore, do të ketë padrejtësi e cila është dialektikë e kundërt e drejtësisë.

PROBLEMI ME PAVARËSINË FINANCIARE TË GJYKATËS ËSHTË I ZGJIDHSHËM

Ky problem mund të zgjidhet me atë që mjetet e punës të Gjykatës Kushtetuese do të përcaktohen në një ndarje të veçantë të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut,¹⁸ me propozim të Gjykatës Kushtetuese, të cilën nuk mund ta ndryshojë as Ministria e Financave, as Qeveria, por vetëm Kuvendi, në procedurën e miratimit të Buxhetit. **Nuk ka pavarësi buxhetore të Gjykatës Kushtetuese nëse për buxhetin e saj vendos Ministria e Financave dhe Qeveria.**¹⁹ Në Seancën e Kuvendit në të cilën do të shqyrtohet dhe vendoset për buxhetin e Republikës, detyrimisht duhet të marr pjesë edhe Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me të drejtë të pjesëmarrjes në diskutim.²⁰ Para se të paraqitet në Kuvend, propozimi do të përcaktohet në mbledhje të Gjykatës Kushtetuese, në të cilën do të marrin pjesë më së paku dy e treta e gjyqtarëve.

18 Lartësia e kësaj ndarje, sipas gjykatës, është nga 0,017% deri 0,020% të Buxhetit.

19 Institucionet më së lehti kontrollohen përmes parave. Në lidhje me këtë, një mendim të thellë filozofik ka fjala e urtë popullore: “sa para aq muzikë.”

20 Në të drejtën komparative kushtetuese-gjyqësore zgjidhje të këtilla ose të ngjashme ka në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Serbisë (neni 28), në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Malit të Zi (neni 113), në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Sllovenisë (neni 8), në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (neni 14), në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë (neni 6).



09

**KUSHTET E PUNËS NË
GJYKATËN KUSHTETUESE**

Gjykata Kushtetuese është vendosur në një objekt të ri, në anën e majtë të lumit Vardar, në afërsi të Urës së Gurit. Përveç gjykatës, në këtë objekt është vendosur edhe Muzeu Arkeologjik dhe Arkivi i Maqedonisë.

Secili nga gjyqtarët dhe nëpunësit kanë zyrë të vet. Megjithatë, nëse gjykata plotësohet me personel konform Rregullores për sistematizimin e shërbimit profesional, atëherë nuk do të ketë zyra të veçanta për secilin nëpunës.

Inventari i zyrave (tavolinat e punës, karriget, dollapët dhe ngjashëm) është i ri dhe i kënaq nevojat e të punësuarve. Secili gjyqtar dhe nëpunës i shërbimit profesional ka në dispozicion kompjuter personal.

Sipas informacioneve nga takimi i punës me kryetarin e gjykatës dhe me bashkëpunëtorët e tij më të afërt, orari i hapësirave e bën atë pamjaftueshëm funksionale.

Objekti nuk ka sallë të veçantë për gazetarë, për pres-konferenca.

Duke e pasur parasysh pozitën dhe rolin e Gjykatës Kushtetuese në rendin kushtetues të Republikës së Maqedonisë së Veriut (instanca më e lartë në mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në Republikë), do të duhej të vendoset në objekt të veçantë të dedikuar në mënyrë speciale vetëm për gjykatën.

Në këtë objekt nuk është siguruar hapësirë adekuate për serverët e gjykatës. Tani, të njëjtit janë vendosur në një hapësirë pa ventilim dhe pa dritare, nëpër të cilën kalojnë tubacionet kryesore të ngrohjes. Duke e pasur parasysh faktin se serverët vazhdimisht nxehen, nevojitet të bëhet një adaptim i hapësirës ekzistuese, ose të sigurohet ndonjë hapësirë tjetër përkatëse për vendosjen e tyre.

Objekti ka ngrohje qendrore të lidhur me ngrohjen qendrore të qytetit.

Për ajër të kondicionuar të hapësirës gjatë periudhës së verës, objekti ka sistem të vet për ftohje, i cili funksionon mirë.

Lokacioni i objektit, sistemi njeri-zyrë, pajisja e zyrave, ndriçimi, ngrohja dhe ftohja e objektit gjyqtarëve dhe personelit të shërbimit profesional ua ofrojnë mundësinë për punë papengesë, për qëndrim gjatë punës, diskrecion gjatë punës me palët dhe komoditet gjatë punës.



10

**LIGJ OSE RREGULLORE PËR
GJYKATËN KUSHTETUESE**

SHUMË SHTETE EVROPIANE KANË LIGJ PËR GJYKATËN KUSHTETUESE, REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT NUK KA

Në praktikën e gjykatave kushtetuese mënyra e punës dhe procedura para tyre rregullohet me ligj ose me rregullore.

Në rajonin e Evropës Juglindore thuaja se të gjitha shtetet kanë Ligj për Gjykatën Kushtetuese. Së këtejmi, Ligj për Gjykatën Kushtetuese ka Republika e Kroacisë, Republika e Sllovenisë, Republika e Serbisë, Republika Serbska, Republika e Malit të Zi, Republika e Kosovës, Republika e Shqipërisë dhe Republika e Bullgarisë. Në Republikën e Kroacisë Ligji për Gjykatën Kushtetuese është në rang të Ligjit Kushtetues. Vetëm në Republikën e Bosnjë e Hercegovinës nuk është miratuar ligj për Gjykatën Kushtetuese, por organizimi i gjykatës, procedura para saj dhe çështje të tjera, të rëndësishme për punën e saj, rregullohen me rregulla të Gjykatës Kushtetuese të Bosnjë e Hercegovinës, të cilat në të vërtetë janë njëloj i rregullores, me të cilën rregullohen çështjet e theksuara.

Nga shtetet e tjera evropiane, Ligj për Gjykatën Kushtetuese ka Austria, Bjellorusia, Gjermania, Letonia, Lituania, Moldavia, Finlanda, Rumania, Çekia, Rusia, Sllovakia, Polonia, Turqia, Hungaria, Ukraina dhe shtete të tjera të cilat kanë gjykata kushtetuese.²¹

Me ligjet për Gjykatat Kushtetuese të shteteve të theksuara në të vërtetë në bazë janë rregulluar bazat e pozitës së gjykatës në rendin kushtetues, çështjet e zgjedhjes, emërimit, pushimit të detyrës dhe pozitës së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, rregullimi i gjykatës, procedura para gjykatës dhe veprimi juridik i vendimeve të saj, ekzekutimi i akteve të gjykatës, si edhe çështje të tjera të rëndësishme për pozitën e saj kushtetuese dhe për kryerjen e punëve në kompetencë të saj.

Rregullimi më i përafërt i organizimit, mënyrës së punës së gjykatës, veprimit para saj, konform ligjeve, rregullohen me rregullore.

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT NUK KA LIGJ PËR GJYKATËN KUSHTETUESE, A DUHET TË KETË?

Komisioni i Venecias, në opinionin e tij CDL-AD(2014)026 nga data 13 tetor të vitit 2014 thekson: **“do të ishte e dobishme të miratohet një ligj i veçantë për Gjykatën Kushtetuese** me të cilin do të rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me statusin e gjyqtarëve të saj, kushtet themelore për ngritjen e procedurës para Gjykatës Kushtetuese, veprimin juridik të aktgjyqimeve të Gjykatës Kushtetuese, etj. Sugjerimi për një ligj të këtillë duhet të inkorporohet në Kushtetutë, që do të thotë se në mënyrë përkatëse duhet të shtohet një paragraf i ri në nenin 113. Megjithatë, nënkuptohet se miratimi i një ligji të këtillë nuk guxon të ndikoj mbi kompetencën e Gjykatës Kushtetuese t'i rregulloj metodat e veta të punës dhe ta trajtojë Rregulloren e punës në Rregulloren e gjykatës.”²²

21 Në disa shtete evropiane, si për shembull në Francë, Suedi, Greqi, Zvicër etj. kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjeve dhe të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të akteve të përgjithshme nënligjore është në kompetencë të Këshillit Shtetëror.

22 Raporti përfundimtar i Misionit, të Jasna Omejec, Misioni i Ekspertëve të TAIEX për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, nga ana e Gjykatës Kushtetuese, Shkup, shkurt viti 2018 (në gjuhën maqedonase) f. 15.

Për nevojën e miratimit të Ligjit të veçantë për Gjykatën Kushtetuese sugjerohet edhe në Raportin Përfundimtar të Misionit të Ekspertëve të TAIEX për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga ana e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë nga viti 2018, të Jasna Omejec, në të cilin theksohet “Në lidhje me statusin e veçantë kushtetues të Gjykatës Kushtetuese, si edhe fakti se vendi nuk ka ligj të veçantë për Gjykatën Kushtetuese, ekzistojnë motive plotësisht të arsyeshme të miratohet një ligj i veçantë me të cilin do të rregullohen pagat dhe kontratat e tjera të punës të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (kompensimet dhe të ardhurat e tjera personale, periudha e punësimit, sigurimi social, pushimi vjetor dhe ditë të tjera të lira, të drejtat pas pushimit të mandatit, etj.)”²³

Në lidhje me nevojën e miratimit të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese kemi parasysh Ligjin e zakonshëm, i cili ashtu si edhe ligjet e tjerë, mund të jetë objekt i vlerësimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese, nëse ligji integral ose ndonjë dispozitë e tij nuk korrespondon me Kushtetutën. **Miratimi i Ligjit Kushtetues për Gjykatën Kushtetuese sipas shembullit të Republikës së Kroacisë në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë së Veriut është i panevojshëm. Ky ligj ka fuqi juridike të Kushtetutës dhe me të njëjtin rregullohen çështje të cilat i përkasin materies kushtetuese.**²⁴ Gjykata Kushtetuese nuk do të ketë mundësi të intervenojë në një ligj të këtillë. Ajo, sipas Kushtetutës, mund ta vlerësoj kushtetutshmërinë e ligjeve, por jo edhe kushtetutshmërinë e Kushtetutës.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nga pavarësia e deri më sot, nuk është miratuar Ligj për Gjykatën Kushtetuese. Sipas nenit 113 të Kushtetutës, “mënyra e punës dhe procedura para Gjykatës Kushtetuese rregullohen me akt të gjykatës”.

Në bazë të kësaj dispozite kushtetuese është miratuar Rregullorja e Gjykatës Kushtetuese. Përveç dispozitave të përgjithshme, Rregullorja përmban dispozita për mënyrën e punës të Gjykatës Kushtetuese; për procedurën e vlerësimit të kushtetutshmërisë të ligjeve dhe kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të akteve normative dhe të akteve të tjera të përgjithshme; për procedurën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave nga neni 110 të Kushtetutës të Republikës së Maqedonisë së Veriut; për procedurën e heqjes së imunitetit, për përcaktimin e përgjegjësisë dhe për përcaktimin e krijimit të kushteve për pushimin e funksionit të Presidentit të Republikës dhe për procedura dhe çështje të tjera në kompetencë të Gjykatës. Është evidente se bëhet fjalë për dispozita të cilat në pjesën më të madhe kanë të bëjnë me mënyrën dhe procedurën para Gjykatës Kushtetuese, (dispozita procesuale), ashtu siç në të vërtetë e përcakton dispozita e cituar e nenit 113 të Kushtetutës.

Dispozita materiale janë përfshirë vetëm në nenet 2 dhe 3 të Rregullores, që kanë të bëjnë me selinë e Gjykatës Kushtetuese dhe me vulën e saj, si dhe në dispozitat e nenit 10, me të cilat rishikohet imuniteti i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Madje edhe një analizë e përciptë të dispozitave të Rregullores së gjykatës mundëson të identifikohet se dispozitat dalin jashtë kornizave të kuadrit ligjor të lejuar për një Rregullore. Rregullorja është akt nënligjor me të cilën rregullohet mënyra dhe procedura e punës së brendshme – veprimi i organit kolektiv dhe çështje të tjera organizative që kanë të bë-

23 Ibid: f. 29, Konkluzioni, numër 6.

24 Shih: Pravna enciklopedija (1979), Savremena administracija, Beograd, odrednica „ustavni zakon.“

jnë me punën e organit kolektiv të karakterit të brendshëm (intern).²⁵ **Në rastin konkret, meqë miratimi i Rregullores, si akt për rregullimin e mënyrës së punës dhe procedurës para gjykatës, është përcaktuar në Kushtetutë, ajo nuk mund të trajtohet si Rregullore e zakonshme, por si akt – Rregullore sui generis.**

Gjatë përcaktimit të mënyrës së punës dhe procedurës para Gjykatës Kushtetuese në mënyrë që të rregullohen me akt të gjykatës, me sa duket kushtetutëbërësit kanë pasur frikë nga mundësia që Kuvendi, me rregullim ligjor të këtyre çështjeve dhe të çështjeve të tjera në lidhje me të njëjtat të ketë ndikim mbi gjendjet në gjykatë, mbi mënyrën e punës së saj dhe procedurave gjatë realizimit të punëve në kompetencë të saj.²⁶ Jemi të mendimit se kjo frikë nuk është e arsyeshme. Gjykata e vlerëson kushtetutshmërinë e të gjitha ligjeve, kështu që gjithsesi se në rast nevojë do ta vlerësojë edhe kushtetutshmërinë e ligjit me të cilin rregullohet mënyra e punës dhe procedura para saj. Së këtejmi, nuk ka shkak për frikë nga miratimi i ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Në atë ligj do të përfshihet një pjesë e konsiderueshme e dispozitave të Rregullores aktuale, që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet e subjekteve jashtë gjykatës. Përveç kësaj, me këtë Ligj, në detaje do të rregullohet statusi i gjyqtarëve dhe statusi i punonjësve në shërbimin profesional të gjykatës, të cilët, sipas pozitës dhe rolit të gjykatës në rendin kushtetues, assesi nuk guxon të trajtohen si nëpunës të zakonshëm administrativ.

Nëse Republika e Maqedonisë së Veriut ka nevojë për miratimin eventual të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, kjo çështje do të elaborohet në detaje në Analizën e thuktë, e cila do të hartohet në kuadër të këtij Projekti.

25 Në lidhje me këtë, tek Savo Klimovski (1997) në "Sistemi kushtetues dhe politik," Prosvetno delo Shkup, f. 394, theksohet: "Me aktin e vet Gjykata Kushtetuese në të vërtetë rregulloi shumë çështje të cilat i tejkalojnë kornizat e marrëdhënieve të brendshme në organizimin e Gjykatës Kushtetuese dhe kornizat e procedurës gjatë veprimit të tij. Në forma të ndryshme, çështje të ndryshme të rregulluara me Rregulloren janë burim normativ i rregullave të sjelljes të subjekteve të ndryshëm në sistemin kushtetues dhe më gjerë në sistemin juridik, duke e përfshirë edhe përcaktimin e pozitës dhe kompetencave të organeve të tjera dhe përcaktimin e përbajtjes të kushteve për realizimin e lirive dhe të drejtave të caktuara të njeriut dhe qytetarit."

26 Në lidhje me këtë Savo Klimovski (1997) në "Sistemi Kushtetues dhe Politik", Prosvetno Dello – Shkup, në faqen 394, shkruan: "Rrethana e theksuar të cilën Gjykata Kushtetuese, me akt të vet, dhe jo Kuvendi, me ligj, i rregulloi të gjitha çështjet që ndërlidhen me ushtrimin e funksionit kushtetues-gjyqësor të cilat mbetën të parregulluara me Kushtetutë, nga aspekti i marrëdhënieve midis Gjykatës Kushtetuese dhe Kuvendit, në shikim të parë mund të duket pozitive nga pikëpamja e pamundësisimit të më të fuqishmit në atë raport (Kuvendi, me të gjitha atributet e pushtetit që i posedon) me akt të vet të ndikoj në mënyrë kufizuese mbi kushtet e ushtrimit të funksionit kushtetues-gjyqësor. Megjithatë edhe atëherë kur ekziston vetëm si mundësi teorike, rregullimi i çështjeve të theksuara, në mënyrë të drejtpërdrejtë me akt të Gjykatës Kushtetuese, mund të jetë një manifestim i deformimit të tij, në të vërtetë një rol pasiv në mbrojtjen e rendit juridik unik dhe në ndërmarrjen e rolit të krijuesit të tij aktit, që nuk i takon sipas funksionit të tij themelor dhe për të cilin nuk e ka legjitimitetin e nevojshëm demokratik."

**TRANSPARENCA NË PUNËN E
GJYKATËS KUSHTETUESE**

GJYKATA KA KUSHTE PËR TRANSPARENÇË

Sipas nenit 84 të Rregullores së Gjykatës Kushtetuese, transparenca në punën e gjykatës sigurohet përmes raportimit në mjetet e informimit publik për mbajtjen e seancave publike, ndërsa sipas vlerësimit të gjykatës edhe për mbajtjen e seancës dhe seancës përgatitore, me prezencë të pjesëmarrësve në procedurë dhe të personave të tjerë, të personave nga organet dhe organizatat dhe përfaqësues të mjeteve të informimit publik për vendimet e gjykatës për çështje me interes për publikun e gjerë.

Gjykata Kushtetuese, sipas nevojës, më së paku dy herë brenda vitit, organizon konferenca për shtyp.

Gjykata Kushtetuese publikon Buletin dhe Përmbledhje të vendimeve – si burime të përhershme për ta njohur publikun me vendimet, opinionet profesionale dhe qëndrimet e saj.

Gjykata ka ueb faqe interneti e cila me sa duket azhurnohet dhe plotësohet rregullisht me të dhëna të reja të rëndësishme për informimin e publikut. Në këtë ueb faqe ka informacione për aktivitetet dhe punën e përditshme të gjykatës, për përbërjen dhe organizimin e gjykatës, aktet themelore juridike; pastaj të dhëna për kompetencën e gjykatës, për pozitat juridike dhe pozitat themelore të gjykatës, për procedurat para gjykatës, për shkresat që kanë të bëjnë me iniciimin e procedurave, për historikun e gjykatës dhe për transparencën e saj.

Gjykata është e hapur për bashkëpunim me organizatat joqeveritare – shoqata të qytetarëve. Në lidhje me këtë në mënyrë të veçantë theksojmë se gjykata, me Institutin për të Drejtat e Njeriut, lidhi Memorandum Bashkëpunimi. Në përputhje me këtë Memorandum përfaqësuesit e Institutit i ndjekin seancat publike.

Sipas Rregullores së gjykatës (neni 26, paragrafi 3), përveç mbajtjes së procesverbalit në seancat për lëndë të caktuara në të cilat trajtohen çështje më të rëndësishme kushtetuese – juridike, sigurohen shënime stenografike, përkatësisht regjistrim në magnetofon (audio) gjatë seancës. Audio regjistrimi është pjesë përbërëse e procesverbalit (neni 45, paragrafi 4).

Gjykata nuk ka person të punësuar për marrëdhënie me publikun (zëdhënës). Punët e zëdhënësit i kryen njëri nga këshilltarët, krahas punëve të përcaktuara me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në shërbimin profesional të gjykatës. Me Rregulloren është parashikuar vendi i punës për person të këtillë, por ky vend i punës akoma nuk është plotësuar.

Gjithashtu, punët në lidhje me dhënien dhe qasjen deri te informacionet me karakter publik, i kryen njëri nga këshilltarët shtetëror, krahas punëve në kompetencë të tij të parashikuara me Rregulloren për sistematizim. Megjithatë, duke e pasur parasysh numrin e vogël të kërkesave të këtilla, kjo për atë nuk paraqet ngarkim të veçantë.

Në lidhje me këtë, përvojat që i imponoi realiteti i ri i pandemisë me COVID-19, konform mundësive të reja teknologjike, e vënë në dukje mundësinë për transmetim të **drejtpërdrejtë -onlajn të seancave**, seancave publike dhe të seancave përgatitore, përmes ndonjëris prej platformave të aksesshme onlajn. Me këtë, gjykata do ta realizojë detyrimin e saj për transparencë dhe publicitet gjatë punës në mënyrë të sigurt, dhe së këtejmi pa u penguar puna e gjyqtarëve gjatë prononcimeve të tyre nga të pranishmit.



12

**BASHKËPUNIMI I GJYKATËS
KUSHTETUESE ME GJYKATAT
KUSHTETUESE TË SHITETEVE TË TJERA**



PËRMES BASHKËPUNIMIT SHKËMBEHEN IDE, NDËR- SA IDETË JANË PROMOTORË TË AKSIONEVE

Sipas nenit 88 të Rregullores, Gjykata Kushtetuese bashkëpunon me Gjykatat Kushtetuese të shteteve të tjera. Bashkëpunimi zhvillohet për çështje me interes për mbrojtjen dhe avancimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit, si dhe për çështje me rëndësi për zhvillimin dhe avancimin e mendimit dhe praktikës kushtetuese-gjyqësore.

Gjatë realizimit të këtij bashkëpunimi gjykata ngrenë iniciativa për shqyrtimin e çështjeve të caktuara, merr pjesë në zgjidhjen e të njëjtave në këshillime të përbashkëta dhe në tubime të tjera profesionale, shkëmben opinione, informacione dhe materiale të tjera dhe realizon forma të tjera të bashkëpunimit. Në këtë drejtim e theksojmë nevojën për **pjesëmarrje aktive të gjyqtarëve dhe nëpunësve të shërbimit profesional me punime të tyre profesionale dhe shkencore**. Kjo do të kontribuojë për afirmimin e tyre personal si profesionistë të spikatur juridikë, dhe njëkohësisht edhe për afirmimin ndërkombëtar të Gjykatës Kushtetuese si vatër e ideve të bazuara mbi përvojat dhe praktikat specifike të gjyqësorit kushtetues maqedonas në mbrojtje të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë dhe të lirive dhe të drejtave të qytetarëve.

KONKLUZIONE

1. Gjykata Kushtetuese është institucion i rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kompetenca kryesore e saj është mbrojtja e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Ajo është institucioni më i lartë i rendit kushtetues për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Si e këtillë është institucion sui generis dhe duhet të jetë e pavarur nga bartësit e pushtetit dhe fuqisë në shoqëri.
2. Pavarësia e gjykatës përbëhet nga tri komponentë: pavarësia funksionale, financiare (buxhetore) dhe administrative.
3. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut nga aspekti formal-juridik i siguron gjykatës një shkallë të lartë të pavarësisë funksionale. Megjithatë, shkalla e lartë e mos harmonizimit ndërmjet aspektit normativ dhe faktik në shoqërinë maqedonase edhe këtu e ka bërë të veten. Gjykata Kushtetuese varet nga bartësit e pushtetit dhe fuqisë në shoqëri.
4. Sipas Kushtetutës (Neni 109, paragrafi 4), gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese zgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur. Megjithatë, kjo dispozitë kushtetuese në praktikë nuk zbatohet në mënyrë konsekuente.
5. Sa i përket financimit, Gjykata Kushtetuese është plotësisht e varur nga Ministria e Financave, nga Qeveria dhe nga Kuvendi. Prandaj, Gjykatës asnjëherë nuk i janë akorduar aq mjete sa ka kërkuar, por, mesatarisht i janë akorduar 20% më pak nga mjetet e nevojshme. Ekzistojnë modele dhe mundësi për sigurimin e nivelit të nevojshëm të pavarësisë buxhetore të gjykatës.
6. Pavarësia administrative e Gjykatës Kushtetuese buron nga struktura organizative e shërbimit profesional, i cili është në shërbim të gjykatës pa të cilin nuk mundet.
7. Nëpunësit e shërbimit profesional kanë status të nëpunësve administrativ. Për punësimin e tyre jep pëlqim dhe siguron mjete financiare Ministria e Financave. Ne jemi të mendimit se ata duhet të kenë status të veçantë si nëpunës kushtetues-gjyqësor.
8. Shërbimi është plotësuar me 30% nga numri i nëpunësve të parashikuar me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës. Ky është burim për mos efikasitetin e shërbimit profesional si shërbim i gjykatës, ndërsa me këtë edhe burim i joefikasitetit të gjykatës.
9. Të ardhurat e gjyqtarëve dhe të nëpunësve në shërbimin profesional nuk korrespondojnë me shkallën e përgjegjësisë së tyre. Kjo ndikon në mënyrë destimuluese ndaj tyre. Të ardhurat e tyre mund të rriten me koeficient adekuat për përlllogaritjen e shumës së pagave, si edhe me dotacione përkatëse në paga dhe kompensime për shpenzime të caktuara.
10. Rregullimi i mënyrës së punës dhe procedurat para Gjykatës Kushtetuese, me Rregulloren, në shikim të parë, në masë të madhe gjykatën e bën të pavarur nga bartësit e pushtetit dhe fuqisë në shoqëri. Megjithatë, faktikisht nuk është kështu.
11. Rregullorja e rregullon mënyrën e punës dhe procedurat para gjykatës, por jo edhe statusin material dhe jomaterial të gjyqtarëve dhe nëpunësve të shërbimit profesional

i cili duhet të korrespondojë me pozitën e tyre shoqërore si pjesëtarë të personelit të Gjykatës Kushtetuese si instancë më e lartë dhe më përgjegjëse për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në Republikë. Rregullorja i rregullon edhe çështjet e tjera në lidhje me punën dhe procedurën para Gjykatës Kushtetuese, ose i rregullon me rregullore, edhe pse një gjë e këtillë duhet të bëhet me ligj, me një ligj të veçantë për Gjykatën Kushtetuese.

- 12.** Miratimi eventual i Ligjit të veçantë për Gjykatën Kushtetuese nuk e përjashton nevojën e rregullimit të detajuar të mënyrës së punës dhe procedurat para gjykatës me Rregullore. Së këtejmi, pas miratimit eventual të ligjit, gjykata duhet të miratojë Rregullore për punën e vet.
- 13.** Në rast të mungesës së vullnetit politik për miratimin e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, çështja e pagave, dotacioneve në paga dhe kompensimeve mund të zgjidhet me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pagën dhe kompensimet e tjera të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të personave të tjerë të zgjedhur dhe emëruar në Republikë. Çështja e statusit të nëpunësve në Gjykatën Kushtetuese – me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për nëpunësit administrativë dhe çështja e ankesës kushtetuese – me ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Gjykatës Kushtetuese, në bazë të interpretimit ekstenziv të nenit, dispozitave të nenit 50 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

LITERATURA E PËRDORUR:

1. Alder J.,(2007) Constitutional and Administrative Law – 6-th edition, Palgrave, Mac-Milan, New York.
2. Caca Gj.,(1994), Liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit në Republikën e Maqedonisë OGB “Studentski zbor”, Shkup.
3. Rregullorja e Gjykatës Kushtetuese (www.ustavensud.mk)
4. Gjorgjeviq J.,(1979), E drejta kushtetuese, Enti i ekonomisë dhe veprimtarive shoqërore, Shkup.
5. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, (2016), Gjykata Kushtetuese midis intereseve politike dhe të drejtave të njeriut, Shkup.
6. Kambovski V.,(2010), Filozofia e të drejtës, Akademia Maqedonase e Shkencave dhe Arteve, Shkup.
7. Klimovski S., (1997), Sistemi kushtetues dhe politik, Prosvetno delo, Shkup,
8. Kodi Penal (www.pravdiko.mk).
9. Nikollovska Caca M. etj., Analiza e pavarësisë së gjyqësorit në Republikën e Maqedonisë, perceptimi, vështirësitë dhe sfidat (2013), Instituti për të Drejtat e Njeriut, Shkup.
10. Nikollovska - Caca M.,(2016) Ankesa kushtetuese, Dialogu juridik, numër 11/2016, Instituti për të Drejtat e Njeriut, Shkup.
11. Omejec J.,(2018) Raporti përfundimtar i misionit – Misioni i Ekspertëve të TAIEX për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga ana e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë JHA –IND/EXP 66095 nga muaji shkurt, i vitit 2018.
12. Rregullore për organizimin e brendshëm të Shërbimit profesional të Gjykatës Kushtetuese (www.ustavensud.mk)
13. Rregullore për sistematizimin e vendeve të punës të shërbimit profesional të Gjykatës Kushtetuese (www.ustavensud.mk)
14. Risteska M., Shurkov E., (2016), Roli transformues i Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë, Qendra për Hulumtimin dhe Krijimin e Politikave, Shkup.
15. Shkariq S., (2004) E drejta kushtetuese komparative dhe maqedonase, Matica Make-donska, Shkup.
16. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut (www.sobranie.mk)
17. Ligje të Republikës së Maqedonisë së Veriut me të cilët rregullohen marrëdhëniet të cilat kanë implikime të drejtpërdrejta ose të tërthorta mbi punën e Gjykatës Kushtetuese.
18. Ligje për gjykatat kushtetuese të Sllovenisë, Kroacisë, Serbisë, Republikës Serbska, Malit të Zi, Kosovës, Shqipërisë, Bullgarisë etj.

